REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"GJIROKASTËR**

**SENATI AKADEMIK**

**Nr 39 Prot.** **Gjirokastër, më 09/01/2020**

**V E N D I M**

**Nr. 01 , datë 09.01.2020**

**PËR DETAJIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2020 PËR ZËRAT PAGAT, SIGURIMET SHOQËRORE DHE BURSAT E STUDENTËVE**

Në zbatim të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", të ligjit nr. 88/2019 "*Për buxhetin e vitit 2020*", të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 49 pika "c", të udhëzimit ne 2, datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, senati akademik diskutoj propozimin e zyrës së administratorit dhe

**V E N D O S I**

1. Të miratoj fondin e pagave për stafin akademik dhe personelin mbështetës në shumën **166.794.418** lekë.
2. Të miratoj fondin e sigurimeve shoqërorë në shumën **29. 500. 000** lekë.
3. Të miratoj fondin për bursat e studentëve në shumën **2. 401. 060** lekë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Një kopje e vendimit i përcillet Bordit të Administrimit.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Adresa: Lagjia "18 Shtatori",Rruga "Studenti", Gjirokaster , Tel: 842-6146, 63408 , Fax: 842- 637776, web: uogj.edu.al, email: rektori@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 39/1 Prot. Gjirokastër, më 09/01/2020

**Lënda:** Përcillet vendimi i Senatit Akademik për miratimin e detajimit të buxhetit për vitin 2020

**BORDI I ADMINISTRIMIT**

**ADMINISTRATORI**

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**

**KËTU**

Bashkangjitur po ju dërgojmë vendimin **nr. 01,** datë **09.01.2019** të Senatit Akademik për zbatim nga ana Juaj.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin,

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE GJIROKASTËR -UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

Adresa: Lagjia "18 Shtatori",Rruga "Studenti", Gjirokaster , Tel: 842-6146, 63408 , Fax: 842- 637776, web: uogj.edu.al, email: rektori@uogj.edu.al

**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**
**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**
**GJIROKASTËR**
**ADMINISTRATORI**

Nr. 189 prot. Gjirokastër, më 05.02.2020

Lënda:

- miratimin e propozimeve për detajimin e buxhetit për vitin 2020.
- miratimin e ndryshimeve në strukturë me shtimin me dy vendeve të reja pune në pozicionin "roje".
- miratimin e financimit të shpenzimeve për projektet me financim të huaj(materiali).
- miratimin e listës së studentëve pretendentues për të përfituar bursë dhe për tu përjashtuar nga pagesa e tarifës së shkollimit .
- miratimin e pagesës për dietat e studentevë pjesmarrës në spartakiadën ndërkombëtare .
- miratimin e përdorimit të fondit të veçantë ( dalje në pension të punonjëseve).
- miratimin e tarifës për aktivitete të studentëve dhe Qeverisë Studentore.
- miratimin e kërkesës së studentes për pagesën e tarifës ne këste

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT**
**KËTU**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

**Propozime për detajimin e buxhetit për vitin 2020**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 " Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit Nr.88/2019 datë 18,12,2019 " Për Buxhetin e Vitit 2020" ; Udhëzimit të përbashkët Nr.20 datë 20.09.2019 të MASR dhe M.F.E "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 " Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor" propozohet për miratim nga ana Juaj, Detajimi i Buxhetit për vitin 2020.

Fondi i akorduar për vitin 2020 nga Buxheti i Shtetit ishte në vlerën prej **198.695.478** lekë i miratuar nga ana Juaj,përkatësisht si më poshtë .

1-**Pagat**.Për stafin akademik dhe personelin mbështetës planifikohet fond page në vlerën prej 166.794.418 lekë kjo nisur nga realizimi i vitit 2019 në mbështetje të VKM-së Nr. 268 datë 29.03.2017, "Për disa ndryshime në VKM. Nr.748 datë 11.06.2009, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit Akademik të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, i ndryshuar ", të VKM-së Nr. 329 datë 11.05.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik" ,të VKM-së Nr. 187 datë 08.03.2017 "Per miratimin e strukturës së pagave të nëpunësve civilë ,nëpunësve ... në institucionet në varësi të ministrave të linjës ", të VKM-së Nr. 202 datë 15.03.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.717 datë 23.06.2009 "Për

pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore " të ndryshuar dhe të udhëzimeve përkatëse , është bërë planifikimi për zërin paga duke patur parasysh faktet si më poshtë :

- strukturën organike aktuale
- numrin e pedagogëve sipas të titujve që mbajnë aktualisht, si dhe kualifikimet e mundshme të tyre me studime pasuniversitere për kalimin e shkallëve të kualifikimit,
- ndryshimet e mundshme në strukturë,
- funksione drejtuese në administratë ,etj.

2-Sigurime shoqërore Sipas ligjit në fuqi për "Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", vlera vjetore e këtyre kontributeve e llogaritur ( 16.7% të fondit të pagës) është 29.500.000 lekë.

3-Bursat e studentëve. sipas v.k.m.-së nr. 903 datë 21.12.2016"Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" të ndryshuar me V.K.M. Nr. 450, datë 22.5.2017 i ndryshuar me V.K.M. Nr. 697, datë 21.11.2018 i ndryshuar me V.K.M. Nr. 784 datë 26.12.2018 e V.K.M. Nr. 755 datë 30.11.2019 planifikohet fondi në vlerën prej 2.401.060 lekë.

| SHPENZIME NGA BUXHETI I SHTETIT | |
|---|---|
| Paga | **166.794.418** |
| Sigurime shoqërore | **29.500.000** |
| Bursa | **2.401.060** |
| **TOTAL** | **198.695.478** |

Buxheti i akorduar për vitin 2020 , është i pamjaftueshëm për të përballuar të gjithë fondin e domosdoshëm për paga, prandaj jemi të detyruar që pjesën tjetër të nevojave për përmbushjen e veprimtarisë financiare të institucionit parashikojmë të planifikohet nga të ardhurat e Universitetit në vlerën 86.367.954 lekë me qëllim realizimin e veprimtarisë normale të institucionit.Planifikimi i fondeve nga të ardhurat e institucionit sipas tabelës së mëposhtme si për paga ashtu edhe për shpenzime operative dhe investime ka pasur si priotitet hartimin e buxhetit sa më real dhe përfaqësues për të gjitha njësitë e Universiteti.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

Parashikojmë për vitin 2020 dhe propozojmë për miratim si më poshtë:

| SHPENZIME NGA TË ARDHURAT DYTESORE TE INSTITUCIONIT | |
|---|---|
| Paga | 30.000.000 |
| Shpenzime operative | 42.655.844 |
| Studime projektime investime | 13.712.110 |
| **TOTAL** | **86.367.954** |

## II-SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJEN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONIT NGA TË ARDHURAT DYTËSORE.

Me qëllim planifikimin e saktë të fondeve për financimine shpenzimeve të vitit 2020 nga të ardhurat dytësore na duhet që të analizojmë situatën konkrete të ardhurave të trashëguara ,si edhe të ardhurave që presim që të krijohen gjatë vitit 2020.
Nëvitin 2019 realizimi i të ardhurave është 32.703.468 lekë.

Nga viti 2018 u trashëguan **105.638.630** lekë të ardhura .
Gjatë vitit 2019 janë përdorur **75.256.545** lekë nga të ardhurat .
Nga viti 2019 për vitin 2020 janë trashëguar fonde në vlerën prej **63.085.552.77** lekë .
Për vitin 2020 kemi parashikuar realizim të ardhurash në vlerën **68.480.000** lekësh, limit ky i përllogaritur në bazë të numrit të kuotave të parashikuara jo vetëm për studentë të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve por edhe për ciklin e tretë,por në fakt sipas numrit të studentëve të rregjistruar në total të ardhurat deri në fund të vitit 2020 parashikohen në vlerën 40.457.053 lekë . Vlera e planifikuar për përdorim nga të ardhurat për vitin 2020 është **86.367.954** lekë. Për vitin 2020 trashëgohet një pjesë e të ardhurave dhe ky fakt do të merret në konsideratë për të patur parasysh planifikimin e shpenzimeve , por duhet të kemi parasysh **se realizimi i të ardhurave mbart në vetvete gjithmonë rriskune realizimit**.Burimi kryesor i krijimit të të ardhurave dytësore janë pagesa e tarifës së shkollimit nga studentët. Për vitin akademik 2019-2020 ashtu si edhe një vit më parë , në vitin akademik 2018-2019 të gjithë studentët e ciklit të parë të studimeve përfitojnë nga V.K.M. Nr. 778 datë 26.12.2019 .Një pjesë e konsiderueshme e studentëve janë përjashtuar nga pagesa e tarifës së shkollimit sipas vendimeve të KM (Nr 269 datë 29.3.2017 të ndryshuar me V.K.M Nr. 40 datë 23.01.2019 ) të cilat janë duke u zbatuar nga hyrja në fuqi e tyre ,duke ndjekur politikat sociale për studentët, për tu përjashtuar nga pagesa e tarifës së shkollimit apo për pagesën në masën 50% të saj. Për vitin akademik 2019-2020 janë shqyrtuar dhe miratuar nga Bordi i Administrimit në muajin dhjetor të vitit 2019 për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit 94 studentë në ciklin e parë të studimeve ,si dhe 21 studentë në ciklin e dytë të studimeve.Kjo ka sjell automatikisht uljen në një masë të ndjeshme të ardhurave në universitet. 940.000 lekë nga studentët të bachelorit si dhe 1.110.000lekë nga studentët që ndjekin studimet në master në total në vlerën prej 2.050.000lekë deri tani ,sepse pranimi i dokumentacionit për trajtimin e studentëve me bursë apo përjashtimin nga tarifa është akoma në proces .

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

**STUDENTË TË PËRJASHTUAR NGA TARIFA E SHKOLLIMIT**

| Nr | Viti akademik | Totali i studenteve | Bachelor | Master profesional | Master shkencor | Shuma lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2016-2017 | 91 | 64 | 23 | 4 | 2.579.539 |
| 2 | 2017-2018 | 132 | 120 | 12 | 0 | 2.940.000 |
| 3 | 2018-2019 | 175 | 148 | 27 | 0 | 2.835.100 |
| 4 | 2019 -2020 | 115 | 94 | 21 | 0 | 2.050.000 |

## SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE DYTËSORE PËR VITIN 2020

Nisur nga situata konkrete financiare e deritanishme si dhe planifikimin e sasisë të të ardhurave dytësore për vitin 2020 do të paraqesim për miratim buxhetin të mbështetur në nevojat reale të funksionimit të institucionit.
Ky planifikim i buxhetit do të mbështetesë zgjidhjen e nevojave dhe problemeve në të cilat ndodhet institucioni dhe të politikave strategjike kombëtare për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë. **Politikat që po ndërmerren nga ana jonë do të konsistojnë në:**

- Rritjen e qëndrueshme afatmesëm të ardhurave të institucionit .

- Vazhdimin e ristrukturimit të arsimit dhe aftësimit profesional, me qëllim përmirësimin e rolit të trainimit të studentëve për nevojat reale të tregut të punës.
- Integrimin e veprimtarisë kërkimore –shkencore me atë të mësimdhënies në nivele reale dhe jo vetëm teorike, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aftësimin profesional të studentit , por edhe për të patur një impakt pozitiv në zhvillimin e rajonit
- Përmbushjen e të gjitha standarteve mbi të cilat do të bëhet akreditimi i institucionit tonë.

Duke iu referuar politikave të mësipërme dhe gjendjes financiare të institucionit shpërndarja e të ardhurave për përdorim për vitin 2020 do të planifikohet mbi bazën e kritereve si më poshtë :

- Për financimin e aktiviteteve (ose shpenzime) me karakter të drejtpërdrejtë për forcimin dhe thellimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
- Financimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit mbi baza reale dhe për nevoja të domosdoshme të funksionimit të tij.
- Mbështetjen financiare të procesit të Akreditimit .
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucionit dhe të sistemit të të dhënave që është implementuar me vite në Universitet.
- Financim për aktivitete shkencore të Departamenteve ku nga produktet e tyre do të kenë përfitim të drejtpërdrejtë komuniteti i qytetit dhe i Qarkut të Gjirokastrës ,
- Financime për qeverinë studentore për aktivitete të ndryshme me karakter social, apo bashkëpunues me qeverinë studentore të universiteteve të tjera.

## 1.<u>PAGA</u>

Duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave nevojitet për tu shpenzuar për paga është planifikuar në vlerën prej **30.000.000** lekë me qëllim për të përballuar :

- pagën e punonjësve të institucionit për dy muaj që nuk mund të sigurohet nga Buxheti i Shtetit .
- pagesën e orëve të pedagogëve të jashtëm.
- pagesën e orëve suplementare të realizuara mbi normën e ngarkesës mësimore sipas udhëzimit Nr.29 datë 10.09.2018 të MASR-së.

Ky fond është planifikuar më i ulët se vitet e kaluara pasi nisur nga vështirësia financiare e institucionit , mendojmë të reduktohen sa të jetë e mundur :

- pagesa e orëve mbi ngarkesën mësimore,
- reduktimi i ngarkesës mësimore për pedagogët e jashtëm
- ulja e numrit të pedagogëve të jashtëm , për ato lëndë që mund të mbulohen me staf akademik të brendshëm.

## 2 .SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJEN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONIT

Në planifikimin e shpenzimeve nga të ardhurat dytësore janë përcaktuar limite të përdorimit të fondeve në nivel të domosdoshëm , kushtëzuar nga sasia e të ardhurave që parashikohen të realizohen, jo vetëm për fondin e pagave por edhe për shpenzimet operative.
Duke analizuar vështirësinë financiare të financimit nga të dy burimet si nga Buxheti i Shtetit ashtu edhe nga të ardhurat dytësore , por edhe domosdoshmërinë e kryerjes së shpenzimeve për

funksionimin normal akademik dhe administrativ të institucionit, planifikimi i fondeve të detajuara sipas zërave janë :

**SHPENZIMET OPERATIVE TË DETAJUARA SIPAS TABELËS**

| Nr | Objekti i Prokurimit | Planifikimi 2020 | |
|---|---|---|---|
| | | Fonde të planifikuara nga grandi | Fonde të planifikuara nga te ardhurat |
| 1 | Karburant | | 2,000,000 |
| 2 | Sherbime te printimit dhe publikimit | | 2,500,000 |
| 3 | Kancaleri, boje fotokopje,printeri | | 2,000,000 |
| 4 | Materiale pastrimi | | 600,000 |
| 5 | Mirembajtje dhe riparim kompjutera fotokopjues, printer | | 480,000 |
| 6 | Materiale elektrike,hidraulike dhe ndertimi | | 500,000 |
| 7 | Ilace dhe materiale per laboratore | | 120,000 |
| 8 | Mirembajtje mjet transporti (dy mjete) | | 600,000 |
| 9 | Sigurimi i detyrueshem i mjeteve autoveture M-Benz,furgon M | | 192,000 |
| 10 | Abonim per sherbim interneti | | 120,000 |
| 11 | Mirembajtje te aparateve kondicionere | | 240,000 |
| 12 | Mirembajtje te kaldajave | | 120,000 |
| 13 | Lyerje fasade | | 120,000 |
| 14 | Pleh organik dhe inorganik | | 48,000 |
| 15 | Sherbim qender zeri | | 24,000 |
| 16 | Dezinfektim i ambjenteve | | 48,000 |
| 17 | Bileta avioni | | 960,000 |
| 18 | Mirembajtje taracave | | 120,000 |
| 19 | Mirembajtje dhe riparime te banjave | | 120,000 |
| 20 | Blerje materiale dhe Sistemim i ambjentit te jashtem | | 240,000 |
| 21 | Mirembajtje sistemi elektrik | | 120,000 |
| 22 | Materiale zgjedhore(studentet) | | 84,000 |
| 23 | Blerje uniformash dhe materiale sportive | | 360,000 |
| | Shuma | | 11,716,000 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| Nr | Objekti i Prokurimit | | Planifikimi 2020 |
|---|---|---|---|
| | | Fonde të planifikuara nga Buxheti I Shtetit | Fonde të planifikuara nga te ardhurat |
| 24 | Rimbushje bombola gazi | | 72,000 |
| 25 | Sherbim i ruajtjes me sistem alarmi | | 120,000 |
| 26 | Energji | | 2,300,000 |
| 27 | Uje | | 800,000 |
| 28 | Telefon | | 600,000 |
| 29 | Sherbim postar | | 115,000 |
| 30 | Sherbime te ndryshme (detyrime tarifore | 5,846,842 | 400,000 |
| 31 | Kosto legale (mirembajtje kontrate etj) | | 276,727 |
| 32 | Kosto te seancave te bordeve ,senati | | 4,905,000 |
| 33 | Dieta (brenda ,jashte,ekspedita ) | | 3,500,000 |
| 34 | Shpenzime per Qeverine Studentore | | 3,000,000 |
| 35 | Trasferta te jashtme 605 | 257,621 | 242,379 |
| 36 | Shpenzime pritje e percjellje | | 700,000 |
| 37 | Aktivitete shkencore, kumtesa,konferenca,projekte te ndryshme | | 3,500,000 |
| 38 | Sherbime te tjera | | 1,800,000 |
| 39 | Materiale specifike | | 200,000 |
| 40 | Sherbime specifike | | 200,000 |
| 41 | Kosto reklam.dhe publikimi (spote, aktivitete, shfaqje etj) | | 500,000 |
| 42 | ProjektiTe Comp UGJ | | - |
| 43 | Projekti Ineco | | - |
| 48 | Miremb. godinave ,lyerje e tre godinave jashte e brenda | | 5,365,000 |
| 49 | Pagese per akreditimin institucional | | 2077488 |
| 50 | Pagese per eksperte te akreditimit institucional | | 266250 |
| | **Shuma** | **6,104,463** | **30,939,844** |
| | **Totali i shpenzimeve operative** | **6,104,463** | **42,665,844** |

Për faktin që këto shpenzime do të mbulohen tërësisht nga të ardhurat dytësore, është planifikuar një vlerë që mbulon nevojat e domosdoshme të institucionit për gjithë vitin kalendarik 2020. Sipas tabelës së mësipërme argumentojmë planifikimin e nivelit të fondit për çdo zë pasi jemi në këtë situatë, ku kemi trashëguar një vlerë të konsiderueshme të adhurash dhe radikalizimi në tërësi i limiteve të përdorimit të të ardhurave, do të çojë në trashegimin e një rezerve sado të vogël të të ardhurave, duke zbatuar dhe duke i dhënë vëmendjen e duhur edhe në këtë pjesë të buxhetit, politikës së rritjes së qëndrueshme afat mesëm të të ardhurave të institucionit,si një politikë e domosdoshme për vështirësinë financiare në të cilën ndodhet institucioni.

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI GJIROKASTER EQREM ÇABEJ

Sipas tabelës së mësipërme argumentojmë planifikimin e nivelit të fondit për cdo zë si më poshtë:

**1-Në zërin karburant** është planifikuar një fond prej **2.000.000** lekë, krahasimisht shumë më i ulët me atë të vitit 2019, kjo nisur nga:

- sasinë e karburantit që kemi gjendje
- krijimin e kushteve optimale jo vetëm në ambientet e zyrave ku kanë edhe ngrohje alternative, por edhe për sallat e leksioneve dhe seminareve,duke ju përgjigjur edhe kërkesave të studentëve për ngrohje
- sasinë e nevojshme për mjetet e trasportit

**2-Në zërin Shërbime të printimit dhe publikimit** parashikohet një vlerë prej **2.500.000** lekë. Do të përballohen shpenzimet për përgatitjen dhe botimin e periodikëve "Kërkime Universitare" për vitin 2020, prodhimi i diplomave, fletpalosje etj. Një vëmendje e vecantë do ti kushtohet nga ana jonë promovimit të Universitetit tonë gjatë gjithë vitit me qëllim arritjen e objektivave si më poshtë;

- rritjen e numrit të studentëve.
- rritjen e impaktit pozitiv në komunitetin e rrethit te Gjirokastrës dhe më gjerë.
- rritjen e kontributit në jetën dhe cilësinë e jetesës së këtij komuniteti .

Gjithashtu kemi planifikuar në këtë vlerë pasi mund të kemi bashkëpunime me institucione të ndryshme për zhvillim të konferencave shkencore si dhe për t`i paraprirë vështirësisë financiare të ekzekutimit të këtyre shpenzimeve planifikojmë mbi eksperiencat e viteve të kaluara, me qëllim mos pengimin e bashkëpunimit të institucionit tonë me partnerë të tjerë

**3-Në zërin Kancelari, bojra :** Parashikohet në vlerën **2.000.000 lekë** për të përballur furnizimin e institucionit me bazë materiale kancelarike, tonera etj. Një peshë të konsiderueshme zënë tonerat e printerave dhe fotokopjuesve,pasi për cdo departament kemi nga 2- 4 printera (ku departamenti mund të ketë edhe nga 10-15 persona) dhe nga një fotokopjues. Gjithashtu edhe zyrat e administratës janë të paisura me printera e fotokopje për të cilat duhet të planifikojme të paktën nga dy- tre bojra në vit në varësi edhe të volumit të punës që ka cdo zyrë.

**4-Në zërat e tjerë kemi planifikuar si më poshtë :**
**materiale pastrimi 600.000 lekë , mirëmbajtje kompjuterike, fotokopjuesish e printerash 480.000 lekë, materiale hidraulike, elektrike e ndërtimi 500.000 lekë, mirëmbajtje kondicioner 240.000 lekë.**Krahasimisht me vitin 2019,është parashikuar thuajse në vlere të njëjtë për arsye të reduktimit në maksimum të shpenzimeve të këtyre zërave dhe duke përdorur me efektivitet sasitë e tyre si ato të reja dhe ato që janë gjendje në magazinë.

**5-Në zërin "Ilace mjekësore, materiale laboratorike bio-kimia"**janë planifikuar fonde në vlerën **120.000** lekë sipas eksperiencës së viteve të kaluara për të përballuar nevojat për ilace mjekësore gjatë zhvillimit të praktikave në terren si dhe materiale të tjera për zhvillimin e punës laboratorike në funksion të procesit mësimor nga Departamenti i Biologji –Kimisë.

**6-Në zërin mirëmbajtje mjete trasporti:** parashikohet në një vlerë **600.000** lekë. Ashtu si edhe më parë peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve e zë mjeti furgon pasi është mjet që është blerë prej vitesh dhe ka një amortizim më të lartë nga viti në vit.Në kushtet e sotme të sasisë së të ardhurave që realizon institucioni, nuk mund të planifikohet blerja e një mjeti të ri, pasi edhe nga vlerësimi i tregut për blerjen e këtyre mjeteve të trasportit do të ketë një kosto të konsiderueshme, shumë herë më të lartë se vlera e mirëmbajtjes së tij.

**7-Në zërin "Mirëmbajtje e Kaldajave dhe gjeneratorëve"** është planifikuar një fond prej **120.000 lekë** për mirëmbajtjen e tyre ose ndonjë defekt të mundshëm që mund të ndodhi gjatë vitit.

**8-Në zërin materiale zgjedhore për studentët** është planifikuar në vlerën prej **84.000** lekë.

**9-Në zërat energji, ujë** janë shpenzime me karakter tarifor dhe është parashikuar në vlera të tilla edhe nga ndryshimet që kanë pësuar këto tarifa gjatë viteve të kaluara. Në zërin e energjisë elektrike është parashikuar një vlerë prej **2.300.000 lekë** për ambjentet ekzistuese.Meqënësë sivjet do të fillojë të bëhet rikonstruksioni i objektit, do të jetë i domosdoshëm shfrytëzimi i rrjetit të energjisë elektrike për kryerjen e punimeve në këtë objekt si dhe vënia në funksionim i godinës vitin tjetër për rrjedhojë kjo vlerë mund të ndryshojë.
Për ujin është planifikuar në vlerën **800.000 lekë** por duke pasur parasysh që në qoftë se do të duhen fonde në vazhdim do të alokojmë sipas nevojave .
**10-Për zërin telefon** parashikohet pagesa për telefoninë fikse por edhe atë celulare sipas ***VKM-së Nr.864 datë 23.07.2010"Për paisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik"***, ku lejohen të trajtohen me pagesën mujore punonjësit e Universitetit sipas pikës 8 dhe 9 të Vendimit të mësipërm dhe kjo vlerë përllogaritet në total ***600.000* lekë** vlerë e cila nuk e tejkalon 2% e vlerës së përgjithshme të institucionit të planifikuar për shpenzimet operative, sic kërkohet në këtë vendim. Nga praktika e viteve të kaluara ka rezultuar se ky fond nuk konsumohet totalisht pasi nga punonjësit përfitues të këtij shërbimi nuk konsumohet e gjithë vlera mujore e përcaktuar për secilin.
**11-Në zërin Shërbimi postar**, parashikohet në vlerën **115.000 lekë** për të përballuar pagesat për shërbimin postar të thjeshtë kryesisht, por edhe shërbimin me postë të shpejtë për ato raste kur gjykohet nga titullari se duhet të përdoret ky shërbim.
**12-Në zërin dieta brenda e jashtë vendit, ekspedita** është parashikuar në një vlerë totale prej **4.460.000 lekë**, ku do të përballohet lëvizja e stafit akademik dhe administrativ jashtë rrethit dhe jashtë vendit, për seminare, trajnime, konferenca, aktivitete dhe projekte të ndryshme, si dhe për praktikat mësimore të studentëve. Këto praktika do të planifikohen të bëhen në terren, duke përballuar lëvizjen e studentëve jashtë qytetit me trasport urban dhe pagesë hoteli për akomodimin e tyre në rast se do të ketë intenerare të tilla.
**13-Zëri kosto të seancave të bordeve, mbledhje senati etj** është parashikuar nga përllogaritjet në **vlerën 4.905.000 lekë**
-për mbledhjet e senatit (për nëntë muaj),
-mbledhjet e anëtarëve të Bordit të Administrimit (për 12 muaj).
**14-Në zërin Shpenzime për Qeverinë Studentore**: si një nga rekomandimet e grupit të ekspertëve për akreditim, është planifikuar një vlerë **prej 3.000.000 lekë**.Është parë e arsyeshme të akordohet dhe të menaxhohet ky fond me qëllim aktivizimin dhe mbështetjen e studentëve në veprimtaritë social-kulturore dhe shkencore me impakt universitar për të qënë jo vetëm kontribues për krijimin e të ardhurave për institucionin, por edhe protagonist për veprimtari të cilat kanë një ndikim pozitiv në jetën e Universitetit, qytetit dhe të rajonit të jugut. Nga ana jonë planifikohet ky fond për të mbështetur qeverinë studentore për të financuar veprimtaritë e tyre, sipas nenit 99, pika 6 e ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Per Arsimin e Larte dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".
**15-Për zërin "Trasferta të jashtme" 605** , planifikohet një fond prej **500.000** lekë për arsye të aderimit të institucionit tonë në organizata ndërkombëtare akademike, të cilat rrisin prestigjin e institucionit tonë, parë kjo si një domosdoshmëri edhe për procesin e akreditimit të Universitetit tonë në të ardhmen vazhdim. Kemi planifikuar dy abonime të cilat kanë qënë të

përvitshme dhe janë konsideruar prestigjoze nga ana jonë për faktin që kanë ndikim pozitiv për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe azhornimin me literaturë bashkohore të stafit akademik, për zhvillimin e karrierës së mëtejshme të tyre . Abonimi në organizatën universitare ndërkombëtare "International Association of Universities " në vlerën 1500 Euro prej shumë vitesh, ku kemi edhe te drejtën e votimit për vendimet që merren në këtë organizatë, si dhe pagesa për antarësimin e Departamentit të Matematikës të Universitetit tonë në periodikun Ndërkombëtar "Springer" , në vlerën 367.5 €.

**16-Në zërin Shpenzime për pritje përcjellje** kemi planifikuar një fond prej **700.000** lekë duke marrë parasysh edhe shpenzimet në vitin 2019 në Universitetit.

**17-Në zërin aktivitete, kërkime shkencore, konferenca kombëtare, veprimtari lokale, projekte** etj kemi planifikuar **3.500.000 lekë** për ti dhënë përparësi kërkimit shkencor, aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare ku përfshihen edhe projektet e papërfunduara të vitit të kaluar.

**18-Në zërin Shërbime të tjera** kemi parashikuar vlerën prej **1.800.000** lekë nga të cilat 50.000 lekë kemi planifikuar për shpenzimet bankare dhe pjesa tjetër parashikohet për kryerjen e shpenzimeve për shërbime të ndryshme që janë të domosdoshme për funksionimin e institucionit si: akte teknike të funksionimit të institucionit (te mbrojtjes nga zjarri, të raporteve higjeno – sanitare), hostim të faqes së UGJ, dhe shërbime të tjera të cilat mund të jenë specifikish për një vit buxhetor.

**19-Në zërin Materiale dhe Shpenzime specifike** parashikohet në një nivel të konsiderueshëm përkatësisht 200.000 për secilin zë në total planifikuar vlera prej **400.000** lekë për të përballuar shërbime të ndryshme sipas rastit të cilat janë konsideruar si të domosdoshme nga ana jonë nga praktika e viteve të kaluara.

**20- Në zërin Kosto reklamimi dhe publikimi** kemi parashikuar vlerën prej **500.000** lekë
Një vëmendje e vecantë do ti kushtohet nga ana jonë promovimit të Universitetit tonë gjatë gjithë vitit me qëllim arritjen e objektivave si më poshtë;

- rritjen e numrit të studentëve.
- rritjen e impaktit pozitiv në komunitetin e rrethit te Gjirokastrës dhe më gjerë.
- rritjen e kontributit në jetën dhe cilësinë e jetesës së këtij komuniteti .

**21-Në zërin Shpenzime për akreditimin e institucionit** duke qenë se akreditimi është një nga instrumentat kryesore për matjen, ruajtjen dhe çertifikimin e cilësisë në Arsimin e Lartë, i cili synon të rrisë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies për plotësimin e kërkesave të studentëve për një arsim të lartë më cilësor, planifikohet në një vlerë prej 2.343.738 lekë, pasi është një proces i certifikimit të cilësisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe shpenzimet për këtë vlerësim duhet të përballohen nga vetë institucioni.Planifikohet në këtë vlerë , sipas Udhëzimit vendimit nr 109 datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë vendimi .shtojca 2 tabela 2/b,të ndryshuar.Tarifat për vlerësimin dhe akreditimin e institucioni të arsimit të larte ,duke përllogaritur tarifën prej 2.077.488 lekë për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional dhe në vlerën prej 266.250 lekë sipas pikës 2 të udhëzimit për "Konsulenca të AAAL " për ti paraprirë përballimit të pagesës në kohë .Gjatë këtij procesi institucioni do të aplikojë edhe për vlerësim të programeve të studimit ,gjithsej për 13 programe .Kemi planifikuar në vlerën prej 2.589.454 të cilën e kemi planifikuar tek zëri shpenzime të ndryshme tarifore (Nr 30 i

rregjistrit). Mendojmë se kjo vlerë do të jetë e mjaftueshme për akreditimin e institucionit,si edhe të programeve.

**Fonde për investime nga të ardhurat dytësore** janë planifikuar në vlerën prej **13.712.110** lekë të ndarë sipas zërave jepen në tabelën e mëposhtme :

**SHPENZIME PËR INVESTIME TË DETAJUARA SIPAS TABELËS**

| | **Objekti i Prokurimit** | **INVESTIME** |
|---|---|---|
| 1 | Rikontruksioni klasave 401.402.403 tek godina B dhe mobilimi i tyre . | 2.400.000 |
| 2 | Supervizor per rikontruksioni klasave 401.402.403 tek godina B | 35.266 |
| 3 | Kolaudim për rikontruksioni klasave 401.402.403 tek godina B. | 10.800 |
| 4 | Blerje aparate kondicionere | 480.000 |
| 5 | Mjete didaktike | 120.000 |
| 6 | Leje per lyerje | 1.000 |
| 7 | Supervizim për lyerje | 107.762 |
| 8 | Kolaudim lyerje | 12.931 |
| 9 | Rikonstruksioni i nyjeve hidrosanitare | 4.741.836 |
| 10 | Supervizor për rikonstruksioni i nyjeve hidrosanitare | 64.703 |
| 11 | Kolaudator për rikonstruksioni i nyjeve hidrosanitare | 17.812 |
| 12 | Sistemi i aspirimit për sallën e bibliotekës | 360.000 |
| 13 | ProjektiTe Comp UGJ | 2.000.000 |
| 14 | Projekti Ineco | 1.400.000 |
| 15 | Blerje pajisje e instrumenta Laboratorike" për Laboratorin e Arkeologjisë dhe Restaurimit | |
| 16 | Dixhitalizimi i Arkivës së Universitetit | 1.000.000 |
| 17 | Libra per biblioteken | 960.000 |
| | **Shuma** | **13.712.110** |

Planifikimi i nevojave për investime për vitin 2020 është bërë mbi bazën e nevojave të evidentuara në institucion me argumentimet përkatëse. Në planifikimin e investimeve nga ana jonë nuk planifikuar rikonstruksionit pjesor të godinës ish Shtëpia e Ushtarakëve.

**1-Në zërin rikonstruksion i klasave 401.402.403 dhe mobilimi i tyre tek godina B** planifikohet fond në vlerën **2.400.000** lekë, për plotësimin e kërkesave bashkëkohore për studentët,si dhe përshtatjen e paisjeve të Lzboratorit të ICT në mësimdhënie .

**2-Në zërin libra për bibliotekën dhe studentët** është parashikuar blerja e një kontigjenti librash për bibliotekën që do tju shërbejë stafit akademik si edhe studentëve, në vlerën prej

**960.000** lekë. Rritja e fondit të librave përmbush edhe një nga rekomandimet e lëna nga grupi i ekspertëvë të akreditimit institucional.

**3- Në zërin blerje aparate kondicionere**: planifikohet një fond prej **480.000** lekë për blerje kondicionerë sipas kërkesave dhe nevojave të Njësive Bazë si dhe kërkesave të Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve.

**4-Në zërin mjete didaktike mësimore**, planifikuar në një vlerë prej **120.000** lekë për përmirësimin e nivelit të mësimdhënies dhe të konkretizimit të orës mësimore në praktikë.

**5-Në zërin rikonstruksioni i nyjeve hidrosanitare** është planifikuar në një vlerë prej **4.741.836** lekë e cila ishte planifikuar dhe prokuruar në vitin 2019 por është akoma e palikujduar .Respektivisht edhe supervizimi dhe kolaudimi i rikonstruksionit .

**6- Në zërin sistemi i aspirimit për sallën e bibliotekës** është planifikuar në një vlerë prej **360.000** lekë .Sistemi i aspirimit të bibliotekës do të mundësojë kushte optimale për mirëmbajtjen e librave në bibliotekë.

**7- Në zërin Dixhitalizimi i arkivit** planifikohet një fond prej **1.000.000** lekë .Nisur nga nevojat bashkëkohore për të pasur akses në cdo kohë dhe për cdo material i cili ndodhet në arkivin e Universitetit planifikojmë vlerën prej 1.000.000 lekë me qëllim realizimin e dixhitalizimit .

Gjithashtu në shpenzime për vitin 2020 kemi planifikuar edhe vlerat prej **3.400.000** lekë përkatësisht për projektet shkencore , ProjektiTe Comp UGJ planifikohet fond prej **2.000.000** lekë dhe për Projektin Ineco planifikohet fondi prej **1.400.000** lekë.Këto fonde janë të celura në vitin 2019 si dhe do të trashëgohen për vitin 2020

Në total, për vitin 2020 planifikojmë në për të plotësuar nevojat e institucionit në shumën prej **297.921.994** lekë, nga të cilat **211.554.040** lekë janë nga buxheti shtetit dhe **86.367.954** lekë janë nga të ardhurat e institucionit, duke pasur si përparësi përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, jetës akademike, mbështetjes studentore, aktiviteteve të ndryshme dhe promovimit të institucionit tonë në rajon e më gjerë, duke krijuar kushte sa më të favorshme për këtë qëllim.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

## PARASHIKIMI I ZËRAVE BUXHETORE PËR VITIN 2020

| Nr | Emërtimi i zërave të Buxhetit | Llogaria Ekono | Viti 2020 | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | total | Ne mije lek | |
| I | Granti dhe të Ardhura | | Ne mije lek | Buxhet | Ardhura |
| | Paga personeli,ore supelementare,orë Part Time | 600 | 196,947,955 | ####### | 30,000,000 |
| | Sigurime shoqërore | 601 | 30,780,823 | ####### | |
| A | TOTALI | 600 + 601 | 227,728,778 | ####### | 30,000,000 |
| | Shpenzime për funksionimin mësimor dhe administrativ të institucionit. | 602 | 48,260,307 | 5,846,842 | 42,413,465 |
| | Trasfertë për pjesëmarrje në konferenca | 605 | 500,000 | 257,621 | 242,379 |
| B | SHUMA | 602+605 | 48,760,307 | 6,104,463 | 42,655,844 |
| C | Bursa për studentët | 606 | 6,975,153 | 6,975,153 | 0 |
| D | Invstime nga te ardhurat (paisje mobileri, , Librat) | 231 | 11,057,756 | 745,646 | 10,312,110 |
| | Granti , investime | | | | |
| | (Superviz.,kolaudator,leje ne bashki) | 230 | 3,400,000 | | 3,400,000 |
| E | Shuma investime | | 14,457,756 | 745,646 | 13,712,110 |
| | **TOTALI** | | ######## | ####### | ###### |
| | | | | | |

**B** Në lidhje me kërkesën për ndryshime në strukturë propozojmë shtesën me dy punonjës në pozicionin "Roje ".

Ju bëjmë me dije se për vitin 2018 institucioni kishte nënshkruar kontratë për shërbim me roje civile .Vlera e likujduar për roje civile në vitin **2018 ishte 5.051.643** lekë për **4.98 roje** në një vend roje,por duke qënë se janë dy vend roje ,një në universitet dhe një vendroje tek ish shtëpia e ushtarakëve në total nevojiteshin **9.96 roje**.

Duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike"në zbatim të vkm 75/2014 të ndryshuar , **llogariten 4.98 roje për një vend roje,ose 9.96 roje për të dy vendrojet .**

Vlera e **një roje** llogaritet **52.881 lekë në muaj pa tvsh ose 63.457 lekë me tvsh** .Në vitin 2019 shërbimi është kryer nga tre roje duke pasur vështirësi në mbulimin e shërbimit ,duke qënë tre punonjës detyrimisht duhej që të punonin edhe mbi tetë orë në kundërshtim me kodin e punës.**Propozojmë që ta mbulojmë këtë shërbim me pesë punonjës për të dy vendrojet**,kjo në pamundësi të kontraktimit të shërbimit me roje private ,pasi kostoja e një roje në muaj është në bazë të pagës referuar VKM-së Nr. 202 datë 15.03.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.717 datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore " **paga bazë 32.500 lekë , paguar në klasën III,** me **kosto mujore 162.500 lekë** për pesë roje pa llogaritur vjetërsine dhe kosto vjetore **1.950.000 lekë**,pa llogaritur vjetërsine.Kostoja mujore e nje roje që do te paguhet me pagen baze 32.500 leke dhe vjetersi 20 vjet është **39.000 lekë .Diferenca mujore është 24.457 lekë .**

**Propozojmë si më poshtë :**

**STRUKTURA AKTUALE**

| Nr | Pozicioni | Kategoria | Klasa | Numri i punonjësve |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Administrator | II-b | | 1 |
| 2 | Drejtor | III-a/1 | | 1 |
| **A** | **SEKTORI FINANCE-PROKURIME** | | | |
| 1 | Përgjegjës sektori finance prokurime | III-b | | 1 |
| 2 | Përgjegjës Zyre Financës | IV-a | | 1 |
| 3 | Specialiste finance | IV-a | | 1 |
| 4 | Specialiste prokurimeve | IV-a | | 1 |
| 5 | Arkëtar | | VII | 1 |
| 6 | Magazinier | | VI | 1 |
| 7 | Specialist inxhinier | IV-a | | 1 |
| **B** | **SEKTORI SHËRBIMEVE** | | | |
| 1 | Përgjegjës sektori shërbimeve | III-b | | 1 |
| 3 | Punonjës informacioni(Sporteliste) | | III | 6 |
| 4 | Sanitare | | I | 6 |
| 5 | Shofere | | IV | 2 |
| 6 | Specialiste Sekretare e Bordit të Admin | IV-a | | 1 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7 | Mirëmbajtës | | IV | 1 |
| 8 | Elektricist | | VI | 1 |
| 9 | Mirëmbajtës i përgjithshëm | | VI | 1 |
| | TOTALI | | | 28 |

**STRUKTURA E PROPOZUAR**

| Nr | Pozicioni | Kategoria | Klasa | Numri i punonjësve |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Administrator | II-b | | 1 |
| 2 | Drejtor | III-a | | 1 |
| **A** | **SEKTORI FINANCE-PROKURIME** | | | |
| 1 | Përgjegjës sektori finance prokurime | III-b | | 1 |
| 2 | Përgjegjës Zyre Financës | IV-a | | 1 |
| 3 | Specialiste finance | IV-a | | 1 |
| 4 | Specialiste prokurimeve | IV-a | | 1 |
| 5 | Specialiste Arkëtar | IV-a | | 1 |
| 6 | Specialiste finance Magazinier | IV-a | | 1 |
| 7 | Specialist inxhinier | IV-a | | 1 |
| **B** | **SEKTORI SHËRBIMEVE** | | | |
| 1 | Përgjegjës sektori shërbimeve | III-b | | 1 |
| 3 | Punonjës informacioni(Sporteliste) | | III | 3 |
| 4 | Roje | | III | 5 |
| 5 | Sanitare | | I | 6 |
| 6 | Shofere | | IV | 2 |
| 7 | Specialiste Sekretare e Bordit të Admin | IV-a | | 1 |
| 8 | Mirëmbajtës | | IV | 1 |
| 9 | Elektricist | | VI | 1 |
| 10 | Mirëmbajtës i përgjithshëm | | VI | 1 |
| | **TOTALI** | | | **30** |

**C MIRATIMIN E FINANCIMIT TË SHPENZIMEVE PËR PROJEKTET ME FINANCIM TË HUAJ(MATERIALI).**

**QUADIC – ERASMUS PLUS**

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të përmirësojë sigurimin e arsimit të lartë në Kosovë dhe Shqipëri ndërtimin e aftësive institucionale për marrëdhëniet ndërkombëtare, përmes të cilit vendosen ose bëhen plotësisht funksionale zyrat përkatëse (përfshirë kapacitetin për menaxhimin e ciklit të projektit) në të tetë universitetet kosovare dhe pesë universitete shqiptare si anëtarë të konsorciumit. Ky projekt do të ndërtojë kapacitete institucionale për ndërkombëtarizimin e arsimit

të lartë në Kosovë dhe Shqipëri dhe do të përmirësojë kapacitetet për zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve ndërkombëtare.
Qëllimi i projektit është krijimi dhe forcimi i atyre trembëdhjetë zyrave plotësisht funksionale tëbashkëpunimi ndërkombëtar në Kosovë dhe Shqipëri që do të përfshijë gjithashtu funksionin e ciklit të projektitmenaxhimit. Aktualisht, asnjë nga universitetet e reja publike në Kosovë dhe në Shqipëri nuk ka aftësinë për të drejtoni një Zyrë të Bashkëpunimit Ndërkombëtar në një mënyrë të plotë, në një kohë kur mbi 50% e studentëve në Institucionet Evropiane të Arsimit të Lartë po studiojnë ose marrin pjesë në një ose një formë tjetër të
studimet ndërkombëtare dhe kur një pjesë e rëndësishme e jetës universitare zhvillohet në formën e ndryshmeshkëmbimet dhe lëvizjet. Kjo e bën me shumë rëndësi krijimin e kapaciteteve përkatëse për anëtarët e konsorciumit. Kjo përfundimisht do të kontribuojë në mënyrë thelbësore në cilësinë e provizionit dhe vullnetitpasurojnë jetën universitare dhe përvojat studentore në Kosovë dhe në Shqipëri. Prandaj,duke pasur parasysh mundësinë e projektit Erasmus + për të mbështetur këtë ide, ne iniciuam këtë ide të funksionimit si një konsorcium për zhvillimin e kësaj ideje. Projekti do të ketë rëndësi shumë të madhe në adresimin izolimi në rritje, mungesa e bashkëpunimit ndërkombëtar cilësor dhe mungesa e iniciativave të projekteve nga Kosova dhe universitetet e Shqipërisë.

Partnere: Universiteti Lubjanes Slloveni, Universiteti Sofjes Bullgari, Universiteti Nices France, 8 Universitete publike Kosove dhe 5 Universitete ( 3 Publike dhe 2 private) Shqiperi

| | |
|---|---|
| Kosto Stafi | 8 505 euro |
| Kosto Udhetimi | 6 750 Euro |
| Kosto akomodimi | 21 345 Euro |
| Pajisje | 13 800 Euro |
| Totali | 50 400 Euro |

**TVSH** që duhet mbuluar 2760 Euro

**BKSTONE - Erasmus Plus**

Partnere
Universiteti Profesional Dhe Edukimit Galicia
Universiteti Kombetar Teknik I Athines
Shkolla E Larte E Restaurimeve Padova Itali
Universiteti Coruna Spanje
Universiteti La Sapienza Rome Itali
Universiteti I Brasov Rumani
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan
Universiteti "Eqrem Çabej"i Gjirokastrës
Universiteti i Prishtinës
Universiteti Ndërkombetar Per Biznes Dhe Teknologji Ubt Shpk
Universiteti i Mostarit
Universiteti Mesdhetar i Podgorices
Universiteti Sarajeves

| | |
|---|---|
| Kosto Stafi | 12 750 euro |
| Kosto Udhetimi | 9 800 Euro |
| Kosto akomodimi | 33 900 Euro |
| Pajisje | 20 000 Euro |
| Totali | 76 450 Euro |

**TVSH** që duhet mbuluar 4000 Euro

**STONEART – IPA CBC**

Qëllimi i përgjithshëm i projektit STONE.ART është ruajtja dhe forcimi i zejtarisë dhe traditës së gurit të rajoneve të Epirit dhe Shqipërisë së Jugut, si një element integral kulturor i zonës së ndërhyrjes, dhe ta vlerësojë atë në mënyrë efektive në fushën e turizmit. Të dy rajonet janë të pasura me peizazhe natyrore dhe monumente të jashtëzakonshme që kombinohen me traditën kulturore mund të ofrojnë shtysë për zhvillimin tematik dhe alternative të turizmit të destinacioneve të rëndësishme në lindje brenda vendit.

Objektivat specifikë të aktiviteteve të parashikuara nga Projekti janë:

i) Dokumentimi dhe analizimi teknikave dhe metodave teë artizanatit të artit prej guri në zonën e ndërhyrjes në lidhje me rëndësinë e tyre historike dhe kulturore;

ii) Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar në fushat e artit, kulturës dhe turizmit;

iii) Rritja e numrit të vizitorëve në Zonën e Ndërhyrjes;

iv) Përmirësimi i tërheqjes në Zonat e Ndërhyrjes,dhe zhvillimi i mekanizmave të TIK dhe markës së përbashkët STONE.ART, për mbështetje të strukturuar të përparimit të turizmit;

v) Trajnimi, shkëmbimi i njohurive dhe përvojave të profesionistëve dhe autoriteteve / organeve në nivelin lokal, rajonal dhe ndërkufitar;

vi) Themelimi i Shkollës së Gurit për ruajtjen dhe vazhdimin e teknikave të hollësishme të ndërtimit si një aset për brezat e ardhshëm;

vii) Mbështetja e turizmit lokal dhe përpjekjeve të menaxhimit kulturor duke siguruar autoriteteve rajonalë dhe lokalë mjete për të krijuar një vizion dhe plan strategjik për rajonin e tyre.Projekti është i përqëndruar në bashkëpunimin ndërkufitar drejt zhvillimit të turizmit tematik dhe alternative, duke manifestuar një orientim të qartë turistik, duke shfrytëzuar pasurinë kulturore dhe trashëgiminë jomateriale të zejtarisë së gurit për të sjellë rritjen ekonomike përmes përparimit të turizmit dhe uljen e papunësisë, duke e zgjatur sezonin turistik dhe përgjimi i tregjeve të reja, plotësisht dhe në mënyrë perfekte në përputhje me SO2.1.

Partnere : Bashkia Konicë, Bashkia Përmet, Universiteti Gjirokaster, Universiteti Janinës

| | |
|---|---|
| Kosto stafi | 18 750 Euro |
| Udhëtime dhe akomodime | 6 105.5 Euro |
| Ekspertizë e Jashtme | 69 000 Euro |
| Pajisje | 15 000 Euro |
| Totali | 109 000 Euro |
| Bashkëfinancimi | 15% |
| **TVSH** për pajisjet | 3000 Euro |

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

**VIRTUALAND IPA CBC**

Projekti "Një eksperiencë gjithëpërfshirëse virtuale për faqet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore" me akronim
"VirtuaLand" i Programit për bashkëpunim ndërkufitar Interreg IPA Interreg "Greqi-Shqipëri 2014-2020"
do të kontribuojë në objektivat e përcaktuara në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar. Këto objektiva
në mënyrë të përmbledhur, janë:

- Tërheq audiencën e re, pasi librat nuk janë gjithmonë në dispozicion ose tërheqës veçanërisht për të rinjtë.
- Kapërcimi i pengesave gjuhësore dhe lidhja e pasurive kulturore që janë shkruar në gjuhë të ndryshme. Anglishtja është mësuar të lidhë larminë gjuhësore, por jo gjithmonë me sukses, pasi nuk janë të kuptueshme nga folës jo-anglezë që përfaqësojnë një pjesë të madhe të njerëzve që jetojnë ose vizitojnë zonën e CB.

- Rritja e aftësisë së agjentëve dhe operatorëve turistikë për të promovuar identitetin lokal dhe rajonal, nga pajisja e tyre me objekte 3D të gatshme për përdorim dhe një platformë VR për të ndërtuar skenarë dhe paketa shtesë pavarësisht se kanë aftësi të kufizuara programimi.

- Përmirësimi i dukshmërisë së pasurive kulturore dhe zonave të bukurisë natyrore të rajoneve pjesëmarrëse. përdoruesitdo të jetë në gjendje jo vetëm të konsumojë informacione të ruajtura në asetet e interesit, por edhe të përjetojë të jetuaritnë një periudhë tjetër kohore, identifikoni kushtet e jetesës së asaj periudhe dhe bashkëveproni me njerëzit,duke rritur përvojën e një turisti që viziton zonën e BQ-së.

- Rezultat i një emri të markës së përbashkët midis Greqisë dhe Shqipërisë, markës "VirtuaLand" që do përfshijnë paketat VR, duke përfshirë mjedisin interaktiv virtual për të promovuar natyrën e përbashkët,identiteti kulturor dhe historik i zonës së interesit.

- Partnere: Universiteti Janines, Universiteti Gjirokastres, Bibloteka Qëndrore Konicë dhe Ngo "Center for Economic Development and International Relations –CEDIR)

Kosto stafi 30500 Euro
Shpenzime zyre 3525 Euro
Udhëtime dhe akomodime 6995.5 Euro
Ekspertizë e Jashtme 30 600 Euro
Pajisje 38 000 Euro
Totali 109 620.5 Euro
Bashkëfinancimi 15%
**TVSH** per pajisjet 7600 Euro

**CheeseCult IPA CBC**

'CheeseCulT' është projektuar për të kapitalizuar përqendrimin agroushqimor të zonës CB në prodhimet e qumështit dhe për ta përfshirë atë në turizmin vendor të qëndrueshëm në një plan zhvillimi të zbatueshëm për rajonet e përfshira.
Kriteri bazë i projektit dhe rezultati kryesor do të jetë identifikimi i lidhjeve midis zinxhirëve të vlerës së baxhos CB dhe potencialit të turizmit përmes Studimeve të Diagnostikimit duke çuar në skicimin/ hartëzimin e një lidhjeje të rrugës së djathit. Rruga e Djathit do të hartëzohet bazuar në aktivitete të tilla si proçedura e kritereve të përzgjedhjes, hartimi i një baze të dhënash përkatëse dhe GIS, duke përdorur të dhëna rajonale për paraqitjen e rrugëve të ndryshme tematike. Skicimi i Rrugës së Djathit do të plotësohet nga një sërë aktivitetesh trajnimi të zhvilluara bashkërisht për palët e interesuara vendore në të dy vendet, duke u përqëndruar në agriturizëm, prodhimin dhe cilësinë e djathit, marketingun dhe inovacionin kulinar.
Trajnimi i përbashkët i grupeve të synuara të diferencuara siç janë prodhuesit dhe ndërmarrjet e turizmit, pritet të krijojë një zinxhir të dobishëm të palëve të interesit të Rrugës së Djathit për mirëkuptim të përbashkët. Përfundimet e tjera do të jenë rezultatet në nismat inovative që lidhen me Rrugën e Djathit. Dorëzimet e këtyre përfshijnë hartimin dhe zbatimin pilot të një plani vendor për zonat e projektit, të kombinuara me vizita shkëmbimi dhe takime për të nxitur bashkëpunimin nga palët e interesuara në të dy vendet, sipas një kornize të krijuar të përbashkët. Një rezultat i rëndësishëm i aktiviteteve të Inovacionit do të jetë krijimi i dy Qendrave të Ekspozitave të Djathit (një në secilin vend) që do të përfshihen në segmente të Rrugës së Djathit dhe do të ofrojnë shërbime për ekspozita dhe përfaqësime të proçedurave tradicionale të baxhove. Si një aktivitet

plotësues, partnerët e projektit do të përgatisin dhe zhvillojnë një version elektronik të një Libri gatimi të përbashkët të djathit. Si rezultat, do të zhvillohet një rrjet Agro-turistik i Djathit për të përfshirë të gjitha ndërmarrjet turistike të interesuara të zonës CB dhe për t'i bashkuar ato me nismën e Rrugës së Djathit.

- Partnere: Universiteti Janines, Universiteti Gjirokastrës, Organizata Bujqësore Demeter ( Shkolla e djathit) dhe NGO "ARGJIRO"

Kosto stafi 18 380 Euro
Shpenzime zyre 2 757 Euro
Udhetime dhe akomodime 3 992.8 Euro
Ekspertize e Jashtme 95220 Euro
Pajisje -
Totali 120 349.8 Euro
Bashkefinancimi 15% i shumës totale

**D** -Në zbatim të V.K.M. Nr. 903 datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", pika 8, i ndryshuar me V.K.M. Nr.450 datë 22.05.2017, VKM Nr. 697 datë 21.11.2018 , **V.K.M. Nr. 784 datë 26.12.2018**, e **VKM Nr. 39 datë 23.01.2019**, po ju paraqesim listën emërore bashkëngjitur të studentëve që të trajtohen me bursë për vitin akademik 2019-2020.
4- në zbatim të V.K.M Nr. 269, datë 29.3.2017 të ndryshuar me V.K.M Nr. 779, datë 26.12.2018, **VKM Nr.40 datë 23.01.2019 si dhe në në zbatim të V.K.M Nr. 780, datë 26.12.2018**.po ju paraqesim listën emërore bashkëngjitur së studentëve të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga pagesa e tarifës së shkollimit në masën 100%, si dhe listën e studentëve të ciklit të dytë të studimeve që përjashtohen nga pagesa e tarifës së shkollimit në masën 50% për tu përjashtuar nga tarifa përkatëse.

**LISTAT E STUDENTEVE NË EXELIN BASHKËNGJITUR**

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**E.**Ekipi sportiv studentor i futbollit për djem është i ftuar për të marrë pjesë në takimin ndërkombëtar PCU GAMES që do të zhvillohet nëqytetin Antërp, Belgjikë në datat sipas kalendarit të miratuar nga Federata Sportive .Për përballimin e shpenzimeve, propozojmë që të paguhen dieta ushqimore për pjesmarrësit në masën 50 euro/ditë, ndërsa pagesa e akomodimit dhe transportit do të bëhet sipas faturave që do të na sjellin pas përfundimit të aktivitetit, bazuar në VKM Nr.870, datë 14.12.2011.

**F.** Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë", neni 52 ,si dhe në mbështetje të të V.K.M. Nr. 929 dt 17.10.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit te vecantë " të ndryshuar me V.K.M. Nr. 493 dt. 06.07.2011 "Për disa ndryshime në V.K.M. Nr. 929 dt 17.10.2010" , pika 7 ,(3 ) " Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera, të cilat përballohen nga fondi faktik i vecantë

përfshihen pagesat për rastet e daljes së punonjësve në pension pleqërie,...rastet e sëmundjeve të rënda kur kërkohet ndërhyrje kirurgjikale ....",të ndryshuar, pagesa për rastet e daljes së punonjësve në pension pleqërie është deri në masën e një page mujore kurse pagesa për rastet e sëmundjeve të rënda dhe kërkohet ndërhyrje kirurgjikale është deri në 50.000(pesëdhjetë mijë ) lekë,propozoj:

**Zj. Irena Shehu** punonjëse pranë institucionit të trajtohen me pagesë në masën e një page për arsye të daljes në pension pleqërie prej 114.703 lekë (bashkëngjitur dokumentacioni i daljes në pension ).

G. Propozojmë që të miratohet nga ana juaj tarifa për aktivitete të studentëve në bashkëpunim me Qeverinë Studentore në vlerën prej 600 lekë/person për organizimin e aktiviteteve (parti).

GJ.Kërkohet miratimi juaj i kërkesës së studentes Danjela Krishti për pagesën e tarifës së shkollimit me dy këste .

Puna jonë edhe në vazhdim,do të konstitoj në rritjen e cilësisë së mësimdhënies duke krijuar kushte sa më të favorshme për të si dhe rritjen e impaktit të Institucionit në rajon dhe më gjerë duke u mbështetur në Ligjin e Buxhetit të Shtetit ,në Ligjin e Arsimit të Lartë , si edhe në stategjinë e Universitetit, duke vendosur prioritete bazuar në kërkesat e strukturave përkatëse.

***Duke J'u falenderuar për bashkëpunimin !***

***Kërkojmë nga ana juaj aprovimin e propozimeve me qëllim realizimin e tyre në vazhdim.***

**ADMINISTRATOR**

**Semi GOLEMI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr.208 Prot.

Gjirokastër, më 12. 02. 2019

**Lënda :** Përcillet vendimi i Bordit të Administrimit për miratimin e Detajimit të Buxhetit për vitin 2019 dhe Regjistrin e Parashikimeve Publike 2019.

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", PROF. DR. BEKTASH MEMA**

**ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", Z. GENTIAN LLOGO**

**KËTU**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

**KRYETAR**

**Dr. Merita Isaraj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

Gjirokastër, më 12. 02. 2019

**VENDIM NR. 11**

Në mbështetje të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 49 pika c., bazuar në shkresën e Administratorit me nr. 199 prot., datë 11. 02. 2019, si dhe në vendimin nr 04 të Senatit Akademik, datë 07. 02.2019 me nr.173 prot., Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 12.02.2019, pasi mori në shqyrtim Detajimin e Buxhetit për vitin 2019

**V E N D O S I:**

**1- Të miratojë detajimin e Buxhetit për vitin 2019**

**Tabela e përmbledhur e Buxhetit për vitin 2019, sipas zërave kryesorë :**

| Nr. | Emërtimi i zërave të Buxhetit | Llogaria Ekonomike | Viti 2019 | Viti 2019 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | (në lekë) | (në lekë) | |
| I | Granti dhe të Ardhura | | | Buxhet | Ardhura |
| | Paga personeli,ore suplementare | 600 | 192,500,000 | 152,014,399 | 40,485,601 |
| | Sigurime shoqërore | 601 | 30,500,000 | 30,500,000 | - |
| A | TOTALI | 600 + 601 | **223,000,000** | **182,514,399** | **40,485,601** |
| | Shpenzime për funksionimin mësimor dhe administrativ të institucionit. | 602 | 34,042,619 | | 34,042,619 |
| | Trasfertë për abonime | 605 | 500,000 | | 500,000 |
| B | SHUMA | 602+605 | **34,542,619** | | **34,542,619** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| C | Bursa për studentët | 606 | **12,457,104** | 12,457,104 | - |
| D | Investime nga te ardhurat (paisje mobileri, kompjuterike, libra) | 231 | 15,144,000 | - | 15,144,000 |
| | Granti, investime | 231 | - | - | - |
| | Supervizim,kolaudator | 231 | 1,426,800 | | 1,426,800 |
| | Leje Ndërtimi Bashki | 230 | - | | |
| | Rikonstruksion dhe shtese e Ish Shtepise Ushtarakeve | 231 | 12,000,000 | | 12,000,000 |
| E | Shuma investime të ardhura 230+231 | | **28,570,800** | - | 28,570,800 |
| | TOTALI | | **298,570,523** | **194,971,503** | **103,599,020** |

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Dr. Merita Isaraj**

RREGJISTRI I PARASHIKIMIT TE PROKURIMEVE PUBLIKE VITI 2019
INSTITUCIONI QENDROR : MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
AUTORITETI KONTRAKTOR : UNIVERSITETI " EQREM CABEJ " GJIROKASTER

| | Objekti i Prokurimit | Fondi limit i parashikuar | | Koha e zhvillimit te tenderit | Procedura e prokurimit | Burimi i financimit | Firma fituese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Investime | Shpenzime | | | | |
| | | Te ardhura | Te ardhura | | | | |
| 1 | Roje civile (kontrate shtese) | | 1,783,408 | Janar | Marrv kuader | Te ardhurat | |
| 2 | Roje amendim(per kontraten shtese ) | | 125,532 | Mars | Marrv kuader | Te ardhurat | |
| 3 | Karburant | | 4,200,000 | Dhjetor | Ker propoz | Te ardhurat | |
| 4 | Sherbime te printimit dhe publikimit | | 960,000 | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 5 | Kancaleri, boje fotokopje,printeri | | 1,498,680 | Dhjetor | Ker propoz | Te ardhurat | |
| 6 | Materiale pastrimi | | 360,000 | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 7 | Mirembajtje kompjuterash | | 240,000 | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 8 | Mirembajtje dhe riparim fotokopjues, printer | | 240,000 | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 9 | Materiale elektrike,hidraulike dhe ndertimi | | 300,000 | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 10 | Ilace dhe materiale per laboratore | | 120,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 11 | Mirembajtje mjet transporti (dy mjete) | | 480,000 | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 12 | Sigurimi i detyrueshem i mjeteve autoveture M-Benz,furgon M-benz | | 192,000 | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 13 | Abonim per sherbim interneti | | 120,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 14 | Mirembajtje te aparateve kondicionere | | 240,000 | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 15 | Mirembajtje te kaldajave | | 120,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 16 | Lyerje fasade | | 120,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 17 | Pleh organik dhe inorganik | | 48,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 18 | Sherbim qender zeri | | 24,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 19 | Dezinfektim i ambjenteve | | 48,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 20 | Bileta avioni | | 960,000 | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 21 | Mirembajtje taracave | | 120,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 22 | Mirembajtje dhe riparime te banjave | | 120,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 23 | Sistemim i ambjentit te jashtem | | 120,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 24 | Mirembajtje sistemi elektrik | | 120,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 25 | Blerje materiale per ambjente te jashtme | | 120,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 26 | Materiale zgjedhore(studentet) | | 84,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 27 | Blerje uniformash dhe materiale sportive | | 360,000 | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 28 | Rimbushje bombola gazi | | 72,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 29 | Sherbim i ruajtjes me sistem alarmi | | 120,000 | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 30 | Energji | | 2,100,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 31 | Uje | | 680,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 32 | Telefon | | 600,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 33 | Sherbim postar | | 123,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 34 | Sherbime te ndryshme (detyrime tarifore bashki, hostim etj ) | | 400,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 35 | Kosto legale (mirembajtje kontrate etj) | | 108,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 36 | Kosto te seancave te bordeve ,senati | | 2,616,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 37 | Dieta (brenda ,jashte,ekspedita ) | | 3,500,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 38 | Shpenzime per Qeverine Studentore | | 3,000,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 39 | Trasferta te jashtme 605 | | 500,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 40 | Shpenzime pritje e percjellje | | 700,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 41 | Aktivitete shkencore, kumtesa,konferenca,projekte te ndryshme etj | | 3,400,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 42 | Sherbime te tjera | | 2,500,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 43 | Materiale specifike | | 200,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 44 | Sherbime specifike | | 200,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 45 | Kosto reklam.dhe publikimi (spote, aktivitete, shfaqje etj) | | 500,000 | Gjate vitit | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| | Totali i shpenzimeve operative | | 34,542,619 | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Paisje kompjuterike dhe elektronike | | | | | | |
| 2 | Paisje zyre mobileri | 240,000 | | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 3 | Mjete didaktike | 960,000 | | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 4 | Libra per biblioteken dhe per studentet | 120,000 | | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 5 | Rikonstruksion i nyjeve hidrosanitare | 2,400,000 | | Dhjetor | Kerk propoz | Te ardhurat | |
| 6 | Supervis nyje hidrosanitare | 6,504,000 | | Dhjetor | Kerk propoz | Te ardhurat | |
| 7 | Kolaudim nyje hidrosanitare | 393,600 | | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 8 | Laboratori i gjuheve te huaja | 121,200 | | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 9 | Rikonstruksion i ish-Shtepise se Ushtarakeve | 2,400,000 | | Dhjetor | Kerk propoz | Te ardhurat | |
| 10 | Supervizim ish shtepia e ushtarakeve | 12,000,000 | | Dhjetor | Kerk propoz | Te ardhurat | |
| 11 | Kulidim ish shtepia e ushtarakeve | 600,000 | | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 12 | Leje ndertimi ish shtepia e ushtarakeve | 240,000 | | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 13 | Blerje kamera vezhgimi, sistem alarmi | 72,000 | | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 14 | Stenda per njoftime | 120,000 | | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 15 | Blerje aparate kondicioner | 120,000 | | Dhjetor | Shkresore | Te ardhurat | |
| 16 | Rikonstruksion ambjente te brendshme | 240,000 | | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 17 | Sistem aspirimi per sallen e bibliotekes | 960,000 | | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| 18 | Trupa kaloriferi te kaldajes | 360,000 | | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| | Shuma e investimeve | 720,000 | | Dhjetor | Prok.drejt | Te ardhurat | |
| | Totali | 28,570,800 | 34,542,619 | | | | |
| | | | 63,113,419 | | | | |

D/SH /UNIVERSITARE
MARIANTHI XHA

P/Z/FINANCES
PARASHQEVI KALANDERI

ADMINISTRATOR
GENTIAN LOGO

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

GJIROKASTËR

ADMINISTRATORI

Nr. 199 prot.

Gjirokastër, më 11.02.2019

Lënda : Propozime për Detajimin e Buxhetit për vitin 2019.

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

KËTU

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* ",të ligjit nr.99/2018 datë 03.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015, "*Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" neni 32 të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 "*Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", të ndryshuar propozohet për miratim nga ana Juaj, Detajimi i Buxhetit për vitin 2019.

Grandi i akorduar për vitin 2019 nga buxheti i shtetit është në vlerën prej 194.971.503 lekë i miratuar nga ana Juaj në datën 09.01.2019. Pjesa tjetër e nevojave për përmbushjen e veprimtarisë financiare të institucionit parashikojmë të planifikohet nga të ardhurat e Universitetit në vlerën 103.599.019 Lekë. Duke u nisur nga sa më poshtë:

Në vitin 2018 realizimi i të ardhurave është në masën 40.870.305 lekë.
Nga viti 2017 janë trashëguar 90.635.218.04 lekë të ardhura.
Gjatë vitit 2018 janë përdorur 25.866.893 lekë nga të ardhurat.
Për vitin 2019 ngelën për tu trashëguar 105.638.630.04 lekë të ardhura .

Ky buxhet hartohet bazuar në disa priorite për institucionin si :

- ***Përmirësime në infrastrukturë***
- ***Kërkime dhe studimet shkencore***
- ***Lidhje komunitare, kombëtare dhe ndërkombëtare***
- ***Qeverisjen bashkëkohore***

këto mbështetur në :

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

[illegible]imin e veprimtarisë kërkimore –shkencore me atë të mësimdhënies në nivele reale dhe jo [illegible] teorike, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aftësimin profesional të studentit për të [illegible] një impakt pozitiv në zhvillimin e rajonit,duke pasur në konsideratë rritjen e qëndrueshme [illegible]mesme të ardhurave të institucionit.

2-Përmbushjen e të gjitha standarteve mbi të cilat do të bëhet akreditimi i institucionit tonë në vazhdimësi duke pasur në vëmendje strategjinë e institucionit.

Në zbatim të Ligjit të ri të Arsimit të Lartë, nga ana jonë për këtë planifikim janë marrë parasysh të gjitha kërkesat e tij, duke parë kushtet reale të funksionimit të institucionit tonë të lidhura ngushtë me mundësitë financiare .

Buxheti i akorduar për vitin 2019 ,siç *jeni* në dijeni është i pamjaftueshëm për të përballuar të gjithë fondin e domosdoshëm për paga e sigurime shoqërore, prandaj jemi të detyruar që të planifikojmë fonde nga të ardhurat e institucionit sipas tabelës së mëposhtme për :

- paga
- shpenzime operative
- investime

| SHPENZIME NGA TË ARDHURAT DYTESORE TE INSTITUCIONIT | |
|---|---|
| Paga | 25.485.600 |
| Pagesa per ore suplementare e pedagoge te jashtem | 15.000.000 |
| Shpenzime operative | 34.542.619 |
| Studime projektime investime | 28.570.800 |
| **TOTAL** | **103.599.019** |

**- SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJEN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONIT NGA TË ARDHURAT DYTËSORE**

**Kriteret e Shpërndarjes së të Ardhurave**

1- Për financimin e aktiviteteve me karakter të drejtpërdrejtë për forcimin dhe thellimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

2- Financimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit mbi baza reale dhe për nevoja të domosdoshme të funksionimit të tij.
3- Promovimin e Universitetit tonë në Rajonin Jugor edhe më gjerë .
4- Mbështetjen financiare të procesit të çeljes së kuotave të ciklit të tretë (të studimeve në doktoraturë).
5- Mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucionit dhe të sistemit të të dhënave që është implementuar me vite në Universitet.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

...ancim për aktivitete shkencore, ku nga produktet e tyre do të kenë përfitim të ...përdrejtë komuniteti i qytetit, qarkut e me gjerë.

...ancime për qeverinë studentore për aktivitete të ndryshme me karakter social-kulturor, apo aktiviteteve bashkëpunimi me qeverinë studentore të universiteteve të tjera, brenda apo jashtë vendit.

Në planifikimin e Shpenzimeve nga të ardhurat dytësore janë përcaktuar limite të përdorimit të fondeve në nivel të domosdoshëm, kushtëzuar nga sasia e të ardhurave që janë trashëguar si dhe nga të ardhurat që parashikohen të realizohen gjatë vitit 2019. Nisur nga numri aktual i studentëve, numrit të tyre që paraqesin dokumenta për tu përjashtuar nga pagesa e tarifës së shkollimit për arsye se u përkasin shtresave në nevojë pavarësisht se ne kemi planifikuar në projekt buxhetin e 2019 mendojme se të ardhurat e krijuara do të jenë në vlerën prej 37.000.000lekë.Këto të ardhura parashikohen sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr | Lloji i të ardhurave | Viti 2019 |
|---|---|---|
| 1 | Qera | 23.854 |
| 2 | Tarifa Shkollimi | 34.401.146 |
| 3 | Vërtetime e te tjera(kredite te pashlyera) | 1.200.000 |
| 4 | Tarife regjistrimi | 1.375.000 |
| | **SHUMA** | **37.000.000** |

Duke analizuar vështirësinë financiare të financimit nga të dy burimet si nga Buxheti i Shtetit po ashtu edhe nga të ardhurat dytësore, por edhe domosdoshmërinë e kryerjes së disa shpenzimeve për funksionimin normal akademik dhe administrativ të institucionit, planifikimi i fondeve të detajuara për tu shpenzuar nga të ardhurat sipas zërave janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

**SHPENZIMET OPERATIVE TË DETAJUARA SIPAS TABELËS**

| Objekti i Prokurimit | | Fondi limit i parashikuar |
|---|---|---|
| | | Shpenzime |
| | | nga te ardhurat |
| Roje civile (kontrate shtese) | | 1,783,408 |
| Roje amendim(per kontraten shtese ) | | 125,532 |
| Karburant | | 4,200,000 |
| Sherbime te printimit dhe publikimit | | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

| | | |
|---|---|---|
| | | 960,000 |
| Kancaleri, boje fotokopje,printeri | | 1,498,680 |
| Materiale pastrimi | | 360,000 |
| Mirembajtje kompjuterash | | 240,000 |
| Mirembajtje dhe riparim fotokopjues, printer | | 240,000 |
| Materiale elektrike,hidraulike dhe ndertimi | | 300,000 |
| Ilace dhe materiale per laboratore | | 120,000 |
| Mirembajtje mjet transporti (dy mjete) | | 480,000 |
| Sigurimi i detyrueshem i mjeteve autoveture M-Benz,furgon M-benz | | 192,000 |
| Abonim per sherbim interneti | | 120,000 |
| Mirembajtje te aparateve kondicionere | | 240,000 |
| Mirembajtje te kaldajave | | 120,000 |
| Lyerje fasade | | 120,000 |
| Pleh organik dhe inorganik | | 48,000 |
| Sherbim qender zeri | | 24,000 |
| Dezinfektim i ambjenteve | | 48,000 |
| Bileta avioni | | 960,000 |
| Mirembajtje taracave | | 120,000 |
| Mirembajtje dhe riparime te banjave | | 120,000 |
| Sistemim i ambjentit te jashtem | | 120,000 |
| Mirembajtje sistemi elektrik | | 120,000 |
| Blerje materiale per ambjente te jashtme | | 120,000 |
| Materiale zgjedhore(studentet) | | 84,000 |
| Blerje uniformash dhe materiale sportive | | 360,000 |
| Rimbushje bombola gazi | | 72,000 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

| | | |
|---|---|---|
| Sherbim i ruajtjes me sistem alarmi | | 120,000 |
| Energji | | 2,100,000 |
| Uje | | 680,000 |
| Telefon | | 600,000 |
| Sherbim postar | | 123,000 |
| Sherbime te ndryshme (detyrime tarifore bashki, hostim etj ) | | 400,000 |
| Kosto legale (mirembajtje kontrate etj) | | 108,000 |
| Kosto te seancave te bordeve ,senati | | 2,616,000 |
| Dieta (brenda ,jashte,ekspedita ) | | 3,500,000 |
| Shpenzime per Qeverine Studentore | | 3,000,000 |
| Trasferta te jashtme 605 | | 500,000 |
| Shpenzime pritje e percjellje | | 700,000 |
| Aktivitete shkencore, kumtesa,konferenca,projekte te ndryshme etj | | 3,400,000 |
| Sherbime te tjera | | 2,500,000 |
| Materiale specifike | | 200,000 |
| Sherbime specifike | | 200,000 |
| Kosto reklam.dhe publikimi (spote, aktivitete, shfaqje etj) | | 500,000 |
| **Totali i shpenzimeve operative** | | **34,542,619** |

Sipas tabelës së mësipërme argumentojmë planifikimin e nivelit të fondit për cdo zë si më poshtë:

1- **Në zërin Roje civile** (kontratë shtesë) kemi planifikuar fondin prej 1.783.408lekë të palikujduar sipas kontratës së lidhur nga prokurimi i vitit 2018 si dhe amendimit të saj si rrjedhojë e ndryshimit të pagës minimale në shkallë vendi për 93 ditë në vlerën prej 125.532 lekë .

**2-Në zërin karburant** është planifikuar një fond prej 4.200.000 lekë, krahasimisht më i lartë me atë të vitit 2018, kjo nisur nga:

- krijimin e kushteve optimale jo vetëm në ambientet e zyrave ku kanë edhe ngrohje alternative, por edhe për sallat e leksioneve dhe seminareve,duke ju përgjigjur edhe kërkesave të studentëve për ngrohje
- sasinë e nevojshme për mjetet e trasportit
- sasinë e karburantit që kemi gjendje

**3-Në zërin Shërbime të printimit dhe publikimit** parashikohet një vlerë prej 960.000 lekë. Do të përballohen shpenzimet për përgatitjen dhe botimin e periodikëve "Kërkime Universitare" për vitin 2019, prodhimi i diplomave, fletpalosje etj.

**4-Në zërin Kancelari, bojra :** Parashikohet në vlerën **1.498.680 lekë** për të përballur furnizimin e institucionit me bazë materiale kancelarike, tonera sipas prokurimit të kryer gjatë vitit 2018 dhe kontratës së lidhur për këtë qëllim.

**5-Në zërat e tjerë kemi planifikuar si më poshtë :**

**materiale pastrimi 360.000 lekë , mirëmbajtje kompjuterike 240.000 lekë, mirëmbajtje fotokopjuesish e printerash 240.000 lekë, materiale hidraulike, elektrike e ndërtimi 300.000 lekë, ilace për laboratorë 120.000 lekë, mirëmbajtje kondicioner 240.000 lekë mirëmbajtje kaldajë 120.000 lekë,etj.**Krahasimisht me vitin 2018,është parashikuar thuajse në vlere të njëjtë ose më të vogël për arsye të reduktimit në maksimum të shpenzimeve të këtyre zërave dhe duke përdorur me efektivitet sasitë e tyre si ato të reja dhe ato që janë gjendje në magazinë. Fakti që këto shpenzime do të mbulohen tërësisht nga të ardhurat dytësore është planifikuar një vlerë që mbulon nevojat e domosdoshme të institucionit për gjithë vitin kalendarik 2019.

**6-Në zërin mirëmbajtje mjete trasporti:** parashikohet në një vlerë 480.000 lekë. Ashtu si edhe më parë peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve e zë mjeti furgon pasi është mjet që është blerë prej mbi 11 vitesh dhe ka një amortizim më të lartë nga viti në vit.Në kushtet e sotme të sasisë së të ardhurave që realizon institucioni, nuk mund të planifikohet blerja e një mjeti të ri, pasi edhe nga vlerësimi i tregut për blerjen e këtyre mjeteve të trasportit do të ketë një kosto të konsiderueshme, shumë herë më të lartë se vlera e mirëmbajtjes së tij.

**7-Në zërin materiale zgjedhore për studentët** është planifikuar në vlerën prej 84.000 lekë për kryerjen e procesit zgjedhor të kandidatit për anëtar të Bordit të Administrimit..

**8-Në zërin blerje uniformash dhe materiale sportive** është planifikuar shuma prej 360.000 lekë.Për vitin 2019 ekipet sportive të studentëve do të jenë pjesmarrës në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo shumë përfshin edhe blerje uniformash për punonjës shërbimi.

**9-Në zërat energji, ujë** janë shpenzime me karakter tarifor dhe është parashikuar në vlera të tilla edhe nga ndryshimet që kanë pësuar këto tarifa gjatë viteve të kaluara. Në zërin e energjisë elektrike është parashikuar një vlerë prej 2.100.000 lekë për ambjentet ekzistuese.Meqënësë sivjet do të bëjmë rikonstruksionin pjesor të objektit, do të jetë i domosdoshëm shfrytëzimi i rrjetit të energjisë elektrike për kryerjen e punimeve në këtë objekt për rrjedhojë kjo vlerë mund



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

ndryshojë . Për ujin është planifikuar në vlerën 680.000 lekë por duke pasur parasysh që në qoftë se do të duhen fonde në vazhdim do të alokojmë sipas nevojave .

**10-Për zërin telefon** parashikohet pagesa për telefoninë fikse por edhe atë celulare sipas ***VKM-së Nr.864 datë 23.07.2010"Për paisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik"***, ku lejohen të trajtohen me pagesën mujore punonjësit e Universitetit sipas pikës 8 dhe 9 të Vendimit të mësipërm dhe kjo vlerë përllogaritet në total 600.000 lekë, vlerë e cila nuk e tejkalon 2% e vlerës së përgjithshme të institucionit të planifikuar për shpenzimet operative, sic kërkohet në këtë vendim. Nga praktika e viteve të kaluara ka rezultuar se ky fond nuk konsumohet totalisht pasi nga punonjësit përfitues të këtij shërbimi nuk konsumohet e gjithë vlera mujore e përcaktuar për secilin.

**11-Në zërin Shërbimi postar**, parashikohet në vlerën 123.000 lekë për të përballuar pagesat për shërbimin postar të thjeshtë kryesisht, por edhe shërbimin me postë të shpejtë për ato raste kur gjykohet nga titullari se duhet të përdoret ky shërbim.

**12-Shërbimi bankar**_ parashikohet në vlerën 50.000 lekë për komisione bankare të ndryshme kryesisht për abonimet jashtë shtetit që i kemi përfshirë tek shpenzimet e ndryshme.

**13-Në zërin dieta brenda e jashtë vendit, ekspedita** është parashikuar në një vlerë totale prej 4.460.000 lekë, ku do të përballohet lëvizja e stafit akademik dhe administrativ jashtë rrethit dhe jashtë vendit, për seminare, trajnime, konferenca, aktivitete dhe projekte të ndryshme, si dhe për praktikat mësimore të studentëve. Këto praktika do të planifikohen të bëhen në terren, duke përballuar lëvizjen e studentëve jashtë qytetit me trasport urban dhe pagesë hoteli për akomodimin e tyre në rast se do të ketë intenerare të tilla.

**14-Zëri kosto të seancave të bordeve, mbledhje senati etj** është parashikuar nga përllogaritjet në vlerën 2.616.000 lekë

-për mbledhjet e senatit (për nëntë muaj),

-mbledhjet e anëtarëve të Bordit të Administrimit (për 12 muaj).

**15-Në zërin Shpenzime për Qeverinë Studentore**: si një nga rekomandimet e grupit të ekspertëvë për akreditim, është planifikuar një vlerë prej 3.000.000 lekë.Është parë e arsyeshme të akordohet dhe të menaxhohet ky fond me qëllim aktivizimin dhe mbështetjen e studentëve në veprimtaritë social-kulturore dhe shkencore me impakt universitar për të qënë jo vetëm kontribues për krijimin e të ardhurave për institucionin, por edhe protagonist për veprimtari të cilat kanë një ndikim pozitiv në jetën e Universitetit, qytetit dhe të rajonit të jugut. Nga ana jonë planifikohet ky fond për të mbështetur qeverinë studentore për të financuar veprimtaritë e tyre, sipas nenit 99, pika 6 e ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Per Arsimin e Larte dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".

**16-Për zërin "Trasferta të jashtme" 605**, planifikohet një fond prej 500.000 lekë për arsye të aderimit të institucionit tonë në organizata ndërkombëtare akademike, të cilat rrisin prestigjin e institucionit tonë, parë kjo si të domosdoshmëri edhe për procesin e akreditimit të Universitetit tonë në të ardhmen. Kemi planifikuar tre abonime të cilat kanë qënë të përvitshme dhe janë

onsideruar prestigjoze nga ana jonë për faktin që kanë ndikim pozitiv për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe azhornimin me literaturë bashkohore të stafit akademik, për zhvillimin e karrierës së mëtejshme të tyre . Abonimi në organizatën universitare ndërkombëtare "International Association of Universities " në vlerën 1500 Euro prej shumë vitesh, ku kemi edhe te drejtën e votimit për vendimet që merren në këtë organizatë, si dhe pagesa për antarësimin e Departamentit të Matematikës të Universitetit tonë në periodikun Ndërkombëtar "Springer" , në vlerën 367.5 €. Abonimi në sitin : http:// ëëë.tradingeconomics.com/analytics, ku vlerësohet nga departamentet tona si një database i plotësuar me informacione ekonomike, shkencore të të gjitha fushave dhe që mund të përdoret nga të gjithë antarët e personelit akademik të universitetit tonë dhe jo vetëm nga Departamentet e Ekonomikut në vlerën 2.000 euro në vit.Nëse gjatë vitit pranë zyrës së Administratorit do të paraqiten kërkesa nga Departamentet për abonime të tjera, ato do të trajtohen me përparësi.

**17-Në zërin Shpenzime për pritje përcjellje** kemi planifikuar një fond prej 700.000 lekë duke marrë parasysh edhe shpenzimet në vitin 2018 në Universitetit.

**18-Në zërin aktivitete, kërkime shkencore, konferenca kombëtare, veprimtari lokale, projekte** etj kemi planifikuar 3.400.000 lekë për ti dhënë përparësi kërkimit shkencor, aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare ku përfshihen edhe projektet e papërfunduara të vitit të kaluar.

**19-Në zërin Shërbime të tjera** kemi parashikuar vlerën prej 2.500.000 lekë nga të cilat 50.000 lekë kemi planifikuar për shpenzimet bankare dhe pjesa tjetër parashikohet për kryerjen e shpenzimeve për shërbime të ndryshme që janë të domosdoshme për funksionimin e institucionit si: akte teknike të funksionimit të institucionit (te mbrojtjes nga zjarri, të raporteve higjeno – sanitare), hostim të faqes së UOGJ, dhe shërbime të tjera të cilat mund të jenë specifikish për një vit buxhetor.

**20-Në zërin Materiale dhe Shpenzime specifike** parashikohet në një nivel të konsiderueshëm prej 400.000 lekë për të përballuar shërbime të ndryshme sipas rastit të cilat janë konsideruar si të domosdoshme nga ana jonë nga praktika e viteve të kaluara.

**21.Kosto reklamimi dhe publikimi** në vlerën 500.000 lekë

Një vëmendje e vecantë do ti kushtohet nga ana jonë promovimit të Universitetit tonë gjatë gjithë vitit me qëllim arritjen e objektivave si më poshtë;

- rritjen e numrit të studentëve.
- rritjen e impaktit pozitiv në komunitetin e rrethit te Gjirokastrës dhe më gjerë.
- rritjen e kontributit në jetën dhe cilësinë e jetesës së këtij komuniteti .

**Fonde për investime nga të ardhurat dytësore** janë planifikuar në vlerën prej 28.570.800 lekë të ndarë sipas zërave jepen në tabelën e mëposhtme :

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

| | Objekti i Prokurimit | INVESTIME |
|---|---|---|
| 1 | Paisje kompjuterike dhe elektronike | 240.000 |
| 2 | Paisje zyre mobileri | 960.000 |
| 3 | Mjete didaktike | 120.000 |
| 4 | Libra per biblioteken dhe per studentet | 2.400.000 |
| 5 | Rikonstruksion i nyjeve hidrosanitare | 6.504.000 |
| 6 | Supervis nyje hidrosanitare | 393.600 |
| 7 | Kolaudim nyje hidrosanitare | 121.200 |
| 8 | Laboratori i gjuheve te huaja | 2.400.000 |
| 9 | Rikonstruksion i ish-Shtepise se Ushtarakeve | 12.000.000 |
| 10 | Supervizim ish shtepia e ushtarakeve | 600.000 |
| 11 | Kualidim ish shtepia e ushtarakeve | 240.000 |
| 12 | Leje ndertimi ish shtepia e ushtarakeve | 72.000 |
| 13 | Blerje kamera vezhgimi, sistem alarmi burime njerz,arshiva | 120.000 |
| 14 | Stenda per njoftime | 120.000 |
| 15 | Blerje aparate kondicioner | 240.000 |
| 16 | Rikonstruksion ambjente te brendshme(zyra e dekanit,klasa 101A,anglisht,mediateke) | 960.000 |
| 17 | Sistem aspirimi per sallen e bibliotekes | 360.000 |
| 18 | Trupa kaloriferi të kaldajës | 720.000 |
| | **Shuma** | **28,570,800** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - GJIROKASTER - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ"

Planifikimi i nevojave për investime për vitin 2019 është bërë mbi bazën e nevojave të evidentuara në institucion me argumentimet përkatëse. Në planifikimin e investimeve nga ana jonë i është dhënë përparësi rikonstruksionit pjesor të godinës ish Shtëpia e Ushtarakëve.

1-**Në zërin pajisje kompjuterike dhe elektronike** planifikohet fond në vlerën 240.000 lekë, për plotësimin e kërkesave parësore,të cilat do të merren në konsideratë bazuar në nevojat e Departamenteve.

2-**Në zërin paisje zyre mobileri :** planifikohet një fond prej 960.000 lekë kryesisht për blerje katedrash,tavolina pune, banka, karrige etj, paisje këto të domosdoshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe rritjen e efikasitetit të infrastrukturës së institucionit.

3-**Në zërin mjete didaktike mësimore,** planifikuar në një vlerë prej 120.000 lekë për përmirësimin e nivelit të mësimdhënies dhe të konkretizimit të orës mësimore në praktikë.

4-**Në zërin libra për bibliotekën dhe studentët** është parashikuar blerja e një kontigjenti librash për bibliotekën që do tju shërbejë stafit akademik si edhe studentëve në vlerën prej 2.400.000 lekë. Rritja e fondit të librave përmbush edhe një nga rekomandimet e lëna nga grupi i ekspertëvë të akreditimit institucional.

5-**Në zërin rikonstruksioni i nyjeve hidrosanitare** është planifikuar fondi prej 6.504.000 lekë, në kuadrin e përmirësimit të infrastrukturës duke krijiuar kushte optimale të saj, si dhe në kuadrin e akreditimit në vitin e ardhshëm.Gjithashtu është planifikuar fondi për supervizim e kolaudim të tyre .

6-**Në zërin laboratori i gjuhëve të huaja** është planifikuar në vlerën prej 2.400.000 lekë. Ky laborator është i domosdoshëm për tu ardhur në ndihmë studentëve të gjuhëve të huaja si edhe domosdoshmëri për të procesin e akreditimit në vazhdim.

7-**Në zërin rikonstruksioni për ish shtëpinë e ushtarakëve** është planifikuar fondi në vlerën prej 12.000.000 lekë, si edhe leje ndërtimi, kolaudim e supervizim.

8-**Në zërin blerje kamera vëzhgimi, sistem alarmi** është planifikuar fondi në vlerën prej 120.000 lekë. Kjo për arsye se shërbimi me roje civile përfundon më datë 04.04.2019 dhe për këtë vit nuk kemi parashikuar shërbim të mëtejshëm me roje.

9-**Në zërin rikonstruksion ambjente te brendshme** përfshihen rikonstruksion i klasës 101A, i një prej klasave të gjuhëvë të huaja, salla e mediatekës, një ndarje në njësinë bazë të Infermierisë, i zyrës së asistentes së dekanit të Fakultetit Ekonomik, i zyrës së dekanit të FESHSH, në vlerën prej 960.000 lekë. Për **sistem aspirimi** në sallën e bibliotekës kemi planifikuar në vlerën prej 360.000 lekë dhe **trupa kaloriferi të kaldajës** në godinënë B kemi planifikuar në vlerën prej 720.000 lekë.

Në total, për vitin 2019 planifikojmë buxhetin e institucionit në shumën prej **298.570.523** lekë, nga të cilat 194.971.503 lekë janë nga buxheti shtetit dhe 103.599.020 lekë janë nga të ardhurat e institucionit, duke pasur si përparësi përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, jetës akademike, mbështetjes studentore, aktiviteteve të ndryshme dhe promovimit të institucionit tonë në rajon e më gjerë, duke krijuar kushte sa më të favorshme për këtë qëllim.

| Nr. | Emërtimi i zërave të Buxhetit | Llogaria Ekonomike | Viti 2019 (në lekë) | Viti 2019 (në lekë) | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Buxhet | Ardhura |
| I | Granti dhe të Ardhura | | | | |
| | Paga personeli,ore suplementare | 600 | 192,500,000 | 152,014,399 | 40,485,601 |
| | Sigurime shoqërore | 601 | 30,500,000 | 30,500,000 | - |
| A | TOTALI | 600 + 601 | **223,000,000** | **182,514,399** | **40,485,601** |
| | Shpenzime për funksionimin mësimor dhe administrativ të institucionit. | 602 | 34,042,619 | | 34,042,619 |
| | Trasfertë për abonime | 605 | 500,000 | | 500,000 |
| B | SHUMA | 602+605 | **34,542,619** | | **34,542,619** |
| C | Bursa për studentët | 606 | **12,457,104** | 12,457,104 | - |
| D | Investime nga te ardhurat (paisje mobileri, kompjuterike, libra) | 231 | 15,144,000 | - | 15,144,000 |
| | Granti, investime | 231 | - | - | - |
| | Supervizim,kolaudator | 231 | 1,426,800 | | 1,426,800 |
| | Leje Ndërtimi Bashki | 230 | - | | |
| | Rikonstruksion dhe shtese e Ish Shtepise Ushtarakeve | 231 | 12,000,000 | | 12,000,000 |
| E | Shuma investime të ardhura 230+231 | | **28,570,800** | - | 28,570,800 |
| | TOTALI | | **298,570,523** | **194,971,503** | **103,599,020** |

1.Në kuadrin e projekteve me financim të huaj propozojmë kryerjen e pagesës për vlerën e tvsh për projektin Teavet për lotin e parë prej 2286 euro për paisjet e blera në kuadër të këtij projekti. Grandi në total për paisjet është 24.000 euro ,në bazë të rregullave të prokurimit të BE paisjet për 8 universitete shqiptare pjesmarrëse në këtë projekt janë kryer nga Universiteti i Vlorës si universitet bashkëkoordinator me BE-në. Vlera totale e TVSH është 4.800 euro . Në këtë kuadër loti i parë i realizuar është për 11.430 euro pa tvsh .T.v.sh. -ja nuk është shpenzim që njihet nga

BE pasi është taksë kombëtare dhe si e tillë universitetit tonë i takon të kryejë pagesën prej 2.286 euro.Universitetit tonë do ti rimbursohet kjo shumë nga Ministri e Financave në një kohë të dytë pasi të jetë kryer pagesa.Pjesa tjetër e lotit të mbetur është në vlerën 12.570 euro e cila do të kalojë në procedura tenderimi sipas procedurave të prokurimit të BE,dhe shuma që Universiteti do të paguajë si vleftë T.V.SH.-je për lotin e dytë është 2514 euro.

Në kuadër të projektit TE COMP grandi i akorduar nga BE për paisje është 35.000 euro pa TVSH.Procedurat e tenderimit të këtij loti për paisje do të bëhen brënda 6-mujorit të parë të vitit 2019 nga Universiteti "Eqrem Çabej".Vlefta e pagesës së T.V.SH.-së do të jetë 7.000 euro.

2.Duke pasur si prioritet plotësimin e nevojave të studentëve bazuar në kërkesën e tyre drejtuar rektoratit, propozojmë shtimin e shërbimit të fotokopjimit në institucion. Për këtë qëllim propozojmë tarifat e mëposhtme;

a) për fotokopje 1(një) faqe formati A4, vlerën 4 lekë
b) për fotokopje 1(një) faqe formati A3, vlerën 8 lekë

Ky shërbim do të kryhet nga personeli administrativ.

3.Studentja Jonida Shurdhi në vitin akademik 2014-2015 ka qenë rregjistruar në degën histori gjeografi master viti I për të cilën ka paguar tarifën e shkollimit në vlerën prej 29.200 lekësh me mandat arkëtimi nr.1120413 ,datë 27.11.2014 por nuk e frekuentoi proçesin mësimor. Me shkresë nr.622 Prot.datë 31.10.2018 ka ndërprerë studimet.Në vitin akademik 2018-2019 është rregjistruar në degën Master Profesional për Mësues Ndihmës në Arsimin Gjithëpërfshirës dhe ka detyrimin për pagesën e tarifës së shkollimit në vlerën 61.700 lekë. Ju paraqesim kërkesën e studentes , që pagesa e kryer për vitin akademik 2014-2015 ti njihet në detyrimin e pagesës për vitin akademik 2018-2019.

4.Ekipi sportiv studentor i futbollit për djemështe i ftuar për të marrë pjesë në takimin ndërkombëtar PCU GAMES që do të zhvillohet nëqytetin Antërp, Belgjikë në datat 24-26 Prill 2019. Për përballimin e shpenzimeve, propozojmë që të paguhen dieta ushqimore për pjesmarrësit në masën 50 euro/ditë, ndërsa pagesa e akomodimit dhe transportit do të bëhet sipas faturave që do të na sjellin pas përfundimit të aktivitetit, bazuar në VKM Nr.870, datë 14.12.2011.

***Kërkojmë nga ana juaj aprovimin e propozimeve me qëllim realizimin e tyre në vazhdim.***

***Duke J'u falenderuar për bashkëpunimin !***

**ADMINISTRATOR**

**Gentian LLOGO**

REPUBLIKA E SHQIPERISE -UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"- GJIROKASTËR

Konceptoi
Marianthi XHA

Universiteti "Eqerem Cabej"
1011108

Situacioni i shpenzimeve per periudhen Janar - dhjetor 2018

| Art | N/Art | ANALIZA Emertimi | ondet e buxhetit Tit 9450,K 8 | Tit09450k6 | Shuma mujore | Tit 9450 K8 | tit09450k6 | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 230 | | PLAN | | | | | | |
| | | Fakt | | 12000 | 12,000 | | 3,474,600 | 3,474,600 |
| | 2302100 | Shpenzime per studime e kerkime | | 12000 | 12,000 | | 138,450.00 | 138,450 |
| 231 | | PLAN | | | | | 138,450.00 | 138,450.00 |
| | | Fakt | 0 | 1604400 | 1604400 | | 46,940,268 | 46,940,268 |
| | 2312101 | Shp,ndertesa administrative | | | | | 7,064,968.00 | 7064968 |
| | 2312103 | Shp,ndertesa shkollore | | | | | 1,849,370.00 | 1,849,370.00 |
| | 2312112 | Shp. Per krijim fond biblioteke | | | | | 26,608.00 | 26,608.00 |
| | 2313500 | Shp. Perinstalimin e rrjetit kompjuterik | | | | | 2,490,550.00 | 2,490,550.00 |
| | 2313600 | Shp.per konstruksionin e rrugeve | | | | | | |
| | 2314110 | Shp.paisje dhe shpenzime instaluaese | | | | | | |
| | 2314130 | Shpenz.Paisje qe sigurojne energji | | | | | | |
| | 2314140 | Shpenz.Paisje dhe insrtrumenta laboratorike | | | | | | |
| | 2314160 | Shpenz .Instalimi i sisitemit te komjuterave | | | | | | |
| | 2314170 | Shpenz .Paisje dhe instalim i kondicionereve | | | | | | |
| | 2314320 | Shpenz mjete dhe paisje te tjerateknike | | | | | 632,400.00 | 632,400.00 |
| | 2315120 | Shpenz. Makina | | | | | | |
| | 2315130 | Shpenz .Autobuze | | | | | | |
| | 2315210 | Shpenz Mjete te tjera | | | | | | |
| | 2318100 | Shpenz. Orendi zyre | | | | | | |
| | 2318400 | Shpenz.Fotokopje | | | | | | |
| | 2318500 | Shpenz. Fakse | | | | | | |
| | 2318600 | Shpenz. Paisje komjuteri | | | | | | |
| A000001 | 2318700 | Shpenz. Te tjera paisje zyre | | 838,800 | 838,800 | | 838,800.00 | 838,800.00 |
| | 2318700 | Ngurtesim garancie per paisje zyre | | 765,600 | 765,600 | | 1,227,240.00 | 1,227,240.00 |
| 466 | | PLAN | | | | | | |
| | | Fakt | | | | | | |
| | 4662103 | Garanci te vitit vazhdim per sigurim kontrat | | | | | | |
| 600 | | PLAN | | | | 189,933,910 | 20,000,000 | 209,933,910 |
| | | Fakt | 19,244,835 | 4,127,894 | 23,372,729 | 189,933,907.00 | 17,019,391.00 | 206,953,298 |
| | 6001001 | Paga baze | 11,971,457 | 1221610 | 13,193,067 | 161,757,484.00 | 12,414,065.00 | 174,171,549 |
| | 6001002 | Raport mjekesor pun. dh. | 6017 | | 6,017 | 31,580.00 | | 31,580 |
| | 6001003 | shtese e vjetersi | 930,027 | | 930,027 | 10,686,477.00 | 1,020,384.00 | 11,706,861 |
| | 6001004 | shtese page veshtiresi | | | | | | |
| | 6001005 | shtese page funksion | 26,784 | | 26,784 | 312,651.00 | 36,865.00 | 349,516 |
| | 6001006 | shtese pune me turne II -III | | | | | | |
| | 6001007 | shtese largesi vend banimi | | | | | | |
| | 6001013 | Shtes per pune jasht.ora. | | | | | | |
| | 6001099 | shtesa page te tjera | | 40884 | 40,884 | 158,869.00 | 234,576.00 | 393,445 |
| | 6002002 | Page per pun.me kontrat | 14,714 | | 14,714 | 292,061.00 | 1,101.00 | 293,162 |
| | 6003100 | shperblime per rez.pune | | | | 51,879.00 | | 51,879 |
| | 6003200 | shperblime takse solidariteti | | | | | | |
| | 6003300 | Paga e 13 - te | | | | | | |
| | 6003900 | Te tjera shperblime personeli. | | | | | | |
| | 6009100 | Shpenzime te tjera personeli | | | | | | |
| | 6001008 | Pagegrupi | 442,494 | | 442,494 | 4,787,068.00 | 447,000.00 | 5,234,068 |
| | 6001014 | shtesa qe pag.akte te vecanta | 5,853,342 | 2,865,400 | 8,718,742 | 11,855,838.00 | 2,865,400.00 | 14,721,238 |
| 601 | | PLAN | | | | 30,000,000 | | 30,000,000 |
| | | Fakt | 2,249,310 | 309,470 | 2,558,780 | 30,000,000.00 | 309,470.00 | 30,309,470 |
| | 6010100 | Kontributeper sig shoqerore | 2,183,079 | | 2,183,079 | 26,814,870.00 | | 26,814,870 |
| | 6011100 | Kontributeper sig shendetsor | 66,231 | 309470 | 375,701 | 3,185,130.00 | 309,470.00 | 3,494,600 |
| 602 | | PLAN | | | | 46,192,000 | [illegible] | [illegible] |
| | | Fakt | 12,252,988 | 615,948 | 12,868,936 | 36,990,853.00 | 1,334,611.00 | 38,325,464 |
| 6020 | 6020100 | Kanceleri | 776,266 | 69,841 | 846,107 | 2,029,464.00 | 69,841.00 | 2,099,305 |
| | 6020200 | Mater.Past,ngrohje e ndriçim | 270,000 | 5,988 | 275,988 | 420,000.00 | 56,388.00 | 476,388 |
| | 6020300 | Materper funks e paisjeve te zyres | | | | 402,500.00 | | 402,500 |
| | 6020400 | Mater.per funk.e paisj.spec. | | | | | | |
| | 6020500 | Kancelerie dokumentacioni | | | | | | |
| | 6020900 | F.mat.Zyra dhe te pergjitheshme | | | | | | |
| | 6020901 | F.mat.Zyra dhe te pergjitheshme | | | | | | |
| | | Shuma | 1,046,266 | 75,829 | 1,122,095 | 2,851,964.00 | 126,229.00 | 2,978,193 |
| 6021 | 6021001 | unifora e veshje te tjera speci | 15,600 | | 15,600 | 15,600.00 | | 15,600 |
| | 6021003 | Iaçe dhe mat mjeksore | | | | | | |
| | 6021007 | Libra dhe publikime speciale | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 6021009 | Material dhe paisje laboratori(elektrik,hidra) | | | | 84,000.00 | 16,000.00 | 100,000 |
| | | | | | | | | |
| | 6021099 | Te tj, mat. Dhe sherbim spec. | 2,898,712 | | 2,898,712 | 5,557,962.00 | | 5,557,962 |
| | | shuma | 2,914,312 | 0 | 2,914,312 | 5,657,962.00 | 16,000.00 | 5,673,962 |
| 6022 | 6022001 | Elektricitet | 7,278 | | 7,278 | 2,018,615.00 | | 2,018,615 |
| | 6022002 | Uje | 110,245 | | 110,245 | 671,353.00 | | 671,353 |
| | 6022003 | Sherbime telefonike | 66,928 | | 66,928 | 811,463.00 | | 811,463 |
| | 6022004 | Posta e sherb.korrier | 22,560 | | 22,560 | 122,322.00 | | 122,322 |
| | 6022007 | sherbime bankare | | | | 13,583.00 | | 13,583 |
| | 6022008 | sherbime te sig e te ruajties | 1,169,821 | | 1,169,821 | 5,051,643.00 | | 5,051,643 |
| | 6022009 | sherb.te pastr.dhe gjelberimit | | | | | | |
| | 6022010 | Sherbime te printimit dhe pub | 76,094 | | 76,094 | 76,094.00 | | 76,094 |
| | 6022011 | kosto e trajnimit dhe e semin. | | | | | | |
| | 6022099 | sherbime te tjera. | 739,570 | | 739,570 | 1,152,350.00 | | 1,152,350 |
| | | shuma | 2,192,496 | 0 | 2,192,496 | 9,917,423.00 | | 9,917,423 |
| 6023 | 6023100 | karburant e vaj | 644,400 | 199,819 | 844,219 | 1,500,000.00 | 199,819.00 | 1,699,819 |
| | 6023200 | pjese kembimi goma e bateri | | | | | | |
| | 6023300 | shpenz.te sigurac.mjeteve tr. | | | | 182,806.00 | | 182,806 |
| | 6023900 | shpenzime te tjera trasporti | | | | 1,000.00 | | 1,000 |
| | | shuma | 644,400 | 199,819 | 844,219 | 1,683,806.00 | 199,819.00 | 1,883,625 |
| 6024 | 6024100 | U.brend.dieta brenda vendit | 383,260 | | 383,260 | 2,765,836.00 | 176,752.00 | 2,942,588 |
| | 6024200 | Udhetim e dieta jasht shtetit | 49,665 | | 49,665 | 1,890,858.00 | | 1,890,858 |
| | | shuma | 432,925 | 0 | 432,925 | 4,656,694.00 | 176,752.00 | 4,833,446 |
| 6025 | 6025300 | shp.per mirem e obj.ndert. | 405,139 | | 405,139 | 3,846,759.00 | 312,665.00 | 4,159,424 |
| | 6025400 | shp.per mirem.e rrugeve. | | | | | | |
| | 6025500 | shp. per mirem e apara. pais. | 1,803,500 | 229,000 | 2,032,500 | 2,028,400.00 | 229,000.00 | 2,257,400 |
| | 6025600 | shp.per miremb e mjet. trasp. | 11,920 | 18,800 | 30,720 | 460,000.00 | 18,800.00 | 478,800 |
| | 6025800 | shp.per miremb e paisjeve te | 30,500 | 42,500 | 73,000 | 344,000.00 | 105,632.00 | 449,632 |
| | | shuma | 2,251,059 | 290,300 | 2,541,359 | 6,679,159.00 | 666,097.00 | 7,345,256 |
| | 6028100 | Shpenzime per kuota qe rrjedh | 1,710,000 | | 1,710,000 | 3,680,900.00 | 99,714.00 | 3,780,614 |
| | | | | | | | | |
| | | shuma | 1,710,000 | 0 | 1,710,000 | 3,680,900.00 | 99,714.00 | 3,780,614 |
| 6029 | 6029001 | shp. per pritje e perc | 1061530 | 50,000 | 1,111,530 | 1,631,780.00 | 50,000.00 | 1,681,780 |
| | 6029002 | shp. per aktiv soc. Personeli | | | | | | |
| | 6029006 | Shpenzime per sigurimin e ndertesave | | | | | | |
| | 6029004 | Shpenzimekompesimi per anetaret e parlamentit | | | | | | |
| | 6029007 | Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca | | | | 231,565.00 | | 231,565 |
| | 6029099 | shp. per te tjera materiale dhe sherbime | | | | | | |
| | | shuma | 1,061,530 | 50,000 | 1,111,530 | 1,863,345.00 | 50,000.00 | 1,913,345 |
| 602 | | Plan | | | | | | |
| | | Fakt | | | 0 | 866,095.00 | | 866,095 |
| | 6040009 | Te tjera transferime | | | | 866,095.00 | | 866,095 |
| 604 | | PLAN | 500,000 | | | 500,000 | | 500,000 |
| | | Fakt | 0 | | | 33,450.00 | | 33,450 |
| | 6059100 | Te tjera transferime korrente jashte shtetit | | | | 33,450.00 | | 33,450 |
| | | | | | | | | |
| 606 | | Plan | | | | 8,368,000 | | [illegible] |
| | | Fakt | 802,620 | | 802,620 | 6,183,075.00 | | 6,183,075 |
| | 6061021 | Bursa Kap 8 | 802,620 | | 802,620 | 6,183,075.00 | | 6,183,075 |
| 606 | | Plan | | | | | | |
| | | Fakt | | | | | | |
| | | Bonuse per shpenz, trans, | | | | | | |
| | | Plan | | | | | | |
| 9770 | | Fakt | | | | | | |
| | | Kerkime shkencore | | | | | | |
| TOTALI | | Plan | | | | 274,992,000 | 75,238,000 | 350,230,000 |
| | | Fakt | 34,549,753 | 6,669,712 | 41,219,465 | 264,007,380.00 | 25,866,890.00 | 289,874,270 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 466 | | PLAN | | | | 116,496 | 116,496 |
| | | Fakt | | | | | |
| | 4662103 | Garanci te vitit vazhdim per sigurim kontrat | | | | | |

Dr. Sherbime Universitare
Marianthi Xha

Specialiste e deges se Thesarit
Lumturi QIRJAQI

Administrator
Gentian Llogo

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

MINISTRIA E FINANCAVE E EKONOMISE DEGA THESARIT GJIROKASTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

Page 1

Qeveria Shqiperise, Accrual
DEGA E THESARIT TE RRETHIT - RAPORTIMI MUJOR (B/A/C)
Current Period: 12-2018

Date: 07-JAN-19 10:15:55
Page: 1

Currency: ALL
Institution=1011108 (Universitet "E. Çabej", Gjirokaster (1111)), Treasury office=1111 (Gjirokaster - Gjirokaster)

| Line | Program | Ch | Inst. | Account | Buxheti | Accrual | Cash |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet (230-232, 600-609, 466) | | | | | | | |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 230 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 600 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 601 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 602 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 604 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 605 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 606 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 04 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 231 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 05 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 230 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 05 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 231 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 05 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 600 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 06 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 602 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 06 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 230 | 0,00 | 138,45 | 138,45 |
| 11 | 09450 | 06 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 231 | 0,00 | 7.064,97 | 7.064,97 |
| 11 | 09450 | 06 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 600 | 0,00 | 17.019,39 | 17.019,39 |
| 11 | 09450 | 06 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 601 | 0,00 | 309,47 | 309,47 |
| 11 | 09450 | 06 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 602 | 0,00 | 1.334,61 | 1.334,61 |
| 11 | 09450 | 06 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 605 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 06 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 606 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | 08 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 600 | 189.933,91 | 189.933,91 | 189.933,91 |
| 11 | 09450 | 08 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 601 | 30.000,00 | 30.000,00 | 30.000,00 |
| 11 | 09450 | 08 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 602 | 46.192,00 | 36.990,95 | 34.789,03 |
| 11 | 09450 | 08 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 605 | 500,00 | 33,45 | 33,45 |
| 11 | 09450 | 08 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 606 | 8.366,10 | 7.049,17 | 6.246,55 |
| 11 | 09770 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 230 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09770 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 231 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| TOTAL DISTRIKTI | | | | | 274.992,00 | 289.874,37 | 286.869,83 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**
**GJIROKASTËR**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 1037/1 Prot. Gjirokastër, më 18 . 08. 2020

**Lënda:** Përcillet vendimi i Bordit të Administrimit për miratimin e Projekt - Buxhetit të detajuar të Universitetit "Eqrem Çabej" për vitin 2021.

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", PROF.DR.BEKTASH MEMA.**

**ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", Z. SEMI GOLEMI**

**KËTU**

**KRYETAR**

**Dr. Merita Isaraj**

Adresa: Lagjia "*18 Shtatori*", rruga Studenti, Gjirokastër www.uogj.edu.al Tel:0035584269023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**
**GJIROKASTËR**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr.1037 Prot.

# VENDIM

**NR.33 , datë 18.08.2020**

## MIRATIMI I PROJEKT - BUXHETIT TË DETAJUAR TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" PËR VITIN 2021

Në mbështetje të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika c., Vendimit nr. 25 të Senatit Akademik me nr. 1035 prot. datë 17/08/2020, si dhe shkresës së Administratorit të Universitetit me nr. 1011 prot., datë 11.08.2020 "Relacion mbi parashikimin e Projekt Buxhetit për vitin 2021", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 18.08.2020,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Projekt - Buxhetin e detajuar të Universitetit "Eqrem Çabej" për vitin 2021 bazuar në relacionin e paraqitur nga Zyra e Financës dhe Administratorit të UGJ-së në Bordin e Administrimit.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Dr. Merita Isaraj**